



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT VJETOR

Drejtoria	Drejtoria e Arsimit
Periudha Raportuese	Janar-dhjetor 2017
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Fatos Osmani

1. PËRMBLEDHJE

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për vitin raportues.

Përkundër sfidave dhe peripecive të shumta, Drejtorinë e Arsimit viti 2017 e karakterizon si një ndër vitet më të suksesshme, me rezultate dhe të arritura të shumta në shumë dimensione të sferës së arsimit. Gjatë kësaj periudhe kohore, janar-dhjetor 2017, janë realizuar me sukses dhe efikasitet të lartë të gjitha punët dhe detyrat e planifikuara sipas dinamikës së paraparë në të katër (IV) nivelet e arsimit parauniversitar, por edhe punë dhe detyra të tjera të paraqitura gjatë këtij intervali kohor.

Edukimi dhe arsimimi i nxënësve në institucionet edukativo-arsimore të komunës së Prishtinës, zhvillohet në gjuhët amtare të të gjitha nacionaliteteve (shqiptar, serb, boshnjak dhe turk).

I. Institucionet parashkollore:

Gjatë vitit shkollor **2016/2017**, veprimtaria edukativo-arsimore në komunën e Prishtinës është zhvilluar në tetë (8) institucione parashkollore publike, gjashtë (6) **IP** me bazë në komunitet dhe një **IP** publiko-privat, të shpërndarë në **118** grup-mosha, ku procesin edukativ e kanë vijuar gjithsej **2114** fëmijë të të gjitha grup-moshave, prej të cilëve dy

fëmijë (2) të nacionalitetit boshnjak, njëmbëdhjetë (11) të nacionalitetit turk dhe dy (2) fëmijë të komuniteteve tjera.

Po ashtu, në komunën e Prishtinës vepron edhe tridhjetë e dy (32) institucione parashkollore private, të licencuara nga MASHT, ku numri i përgjithshëm në këto institucione është gjithsej 1375 fëmijë.

II. Institucionet e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët

Në komunën e Prishtinës, gjatë vitit shkollor **2016/2017**, veprimtarinë e vet edukativo-arsimore e kanë zhvilluar **42** institucione edukativo-arsimore me **18** paralele të ndara, me gjithsej **32921** nxënës, të organizuar në **1434** paralele, prej të cilëve **19** nxënës të nacionalitetit boshnjak, **80** të nacionalitetit ashkali, **3** të nacionalitetit rom, **70** nxënës të nacionalitetit serb, **163** nxënës të nacionalitetit turk dhe **1** nxënës i nacionalitetit goran. Ndërsa, aktivitetin edukativo-arsimor e kanë zhvilluar edhe shtatë (**7**) shkolla private, me gjithsej **1539** nxënës.

Në institucionet e arsimit fillor të komunës së Prishtinës, gjatë vitit shkollor **2016/2017**, në paralelet e arsimit parafillor kanë qenë të regjistruar **2224** nxënës, të sistemuar në 113 paralele. Ndërsa në klasën e parë kanë qenë të regjistruar **3512** nxënës, të sistemuar në **151** paralele.

III Institucionet e arsimit të mesëm të lartë

Në vitin shkollor **2016/2017**, në komunën e Prishtinës, veprimtaria edukativo-arsimore është zhvilluar në **13** institucione edukativo-arsimore, me **10361** nxënës, të sistemuar në **345** paralele, prej tyre **9** nxënës të nacionalitetit boshnjak, **64** nxënës të nacionalitetit turk dhe **3** nxënës të nacionalitetit ashkali. Kurse aktivitetin edukativo-arsimor e kanë zhvilluar edhe nëntë (**9**) shkolla private, me gjithsej **1244** nxënës.

Në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar në institucionet publike, punojnë **3124** mësimdhënës dhe personel tjetër tekniko-administrativ dhe udhëheqës.

AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara me planprogramin e Komunës për drejtorinë tuaj:

- Mbikëqyrje të vazhdueshme të procesit edukativo-arsimor;
- Vizita të përgjithshme-këshilluese në institucionet arsimore;
- Hartimi i Planit zhvillimor për arsim në komunën e Prishtinës 2018-2022, në bashkëpunim me organizatën KEEN;
- Operimi i ekipit profesional në mbështetje të shkollave për ngritjen e cilësisë në arsim;
- Lidhja e marrëveshjes për bashkëpunim në mes të Komunës së Prishtinës dhe KEEN-së;
- Formimi i ekipit profesional për ngritjen e cilësisë në arsim në nivel komunal;

- Funkcionalizimi dhe fuqizimi aktiveve profesionale (seksioneve), në funksion të zhvillimit, mbështetjes dhe përmirësimit të cilësisë në arsim;
- Analiza e nevojave për stafin menaxhues dhe hartimi i plan të trajnimit;
- Organizimi i trajnimeve për stafin menaxhues në përputhje me nevoja dhe planet e trajnimeve;
- Krijimi i skemave për stimulimin e menaxhimit të suksesshëm në institucionet- edukativo-arsimore;
- Zbatimi i stimulimit për suksese në menaxhimin e institucionit edukativo-arsimore;
- Delegimi i autorizimeve nga niveli qendror në nivelin lokal dhe shkollë;
- Njohja e personelit me autorizime të reja;
- Themelimi i Këshillit të prindërve në nivel komunal;
- Ushtrimi i autorizimeve të bartura në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Bashkëpunimi me këshillat drejtues të institucioneve edukativo-arsimore;
- Përkrahje në themelimin e këshillave drejtues, sipas nevojës;
- Fuqizimi i Këshillit drejtues të shkollës;
- Punësimi i personelit të ri në përputhje me nevojat e paraqitura;
- Kontrollim dhe monitorim i rregullt institucioneve parashkollore sipas dinamikës së planifikimit;
- Themelimi i institucioneve parashkollore me komunitetin në bazë;
- Themelimi i paraleleve të reja parashkollore në kuadër të shkollave fillore;
- Organizimi i trajnimeve permanent për zhvillimin profesional të personelit edukativ-arsimor, në bashkëpunim (MASHT, OJQ-të);
- Publikimi i listës së institucioneve parashkollore publike dhe private të licencuar në ueb-faqe të Komunës;
- Organizimi dhe mbajtja e "Garës së diturisë", për nivelin e arsimit të mesëm të ulët;
- Organizimi i garës "Shkencëtari i ri";
- Organizimi i diskutimeve publike me komunitetin e prekur nga riorganizimi i rrjetit të shkollave;
- Organizimi dhe mbajtja e garës "Olimpiada matematike";
- Organizimi i garës "Gjuhëtari i ri";
- Gara për pikturën më të mirë;
- Identifikimi dhe përcaktimi i mësimdhënësve për 7 fushat, sipas KKK-së;
- Identifikimi dhe përcaktimi i mësimdhënësve të dalluar;
- Bashkëpunimi me institucionet e ndryshme qeveritare (MASHT), Institutin Pedagogjik, KEC, GIZ etj.;
- Angazhimi i ekspertëve të jashtëm;
- Mentorimi i shkollave gjatë tërë vitit;
- Operimi i ekipit vlerësues profesional për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;
- Monitorimi dhe integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe rekomandimet për adresim më efektiv të problemeve;
- Analiza e trendit të regjistrimit të nxënësve dhe hartimi i propozimeve për regjistrim në vitin shkollor vijues;
- Hartimi i propozimit për MASHT për regjistrimin e nxënësve në shkollat e mesme në vitin shkollor 2017/18;

- Organizimi i konsultimeve me shkolla lidhur me funksionimin e ekipeve për zhvillim profesional;
- Krijimi i ekipeve për zhvillim profesional me bazë në shkollë;
- Përgatitja dhe trajnimi i mësimeve për implementimin e Kurrikulës së re (në bashkëpunim me MASHT);
- Fillimi i zbatimit të mësimit tërëditorë në shkollat pilot;
- Hulumtimi i nevojave për zhvillim profesional të mësimeve;
- Vlerësimi i performancës së mësimeve në nivel shkollë;
- Shqyrtimi i legjislacionit në fuqi në lidhje me vlerësimin e performancës së mësimeve;
- Identifikimi i shkollave që kanë hapësirë për zhvillimin e mësimit tërëditorë;
- Bashkëpunimi me institucionet e ndryshme: FE, drejtoritë komunale, bibliotekat, muzeun, klubet sportive etj.;
- Funksionalizimi i instrumenteve për monitorim dhe vlerësim brenda komunës;
- Organizimi i mësimit joformal në tri nivelet e arsimit parauniversitar (në bashkëpunim me MASHT dhe Qendrën Rajonale të Aftësisë Profesionale);
- Implementimi i riorganizimit të rrjetit të shkollave në përputhje me rekomandimet;
- Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave nga “Testi i arritshmërisë”;
- Përgatitja e qendrave testuese për organizimin dhe zhvillimin e “Testit të arritshmërisë”;
- Koordinimi dhe angazhimi i administruesve dhe monitoruesve për mbarëvajtjen e “Maturës shtetërore 2017”;
- Koordinimi me MASHT-in për organizimin e “Maturës shtetërore 2017”;
- Grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave lidhur me përfundimin e suksesit të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2016/17;
- Grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave, mbi rezultatet dhe suksesin e arritur në secilën lëndë të nivelit të arsimit parauniversitar;
- Grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave, lidhur me përfundimin e suksesit të fundvitit shkollor 2016/17, për të tri nivelet e arsimit parauniversitar, publike dhe private;
- Grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave mbi rezultatet dhe suksesin e arritur në secilën lëndë gjatë vitit shkollor 2016/17, në të tri nivelet e arsimit parauniversitar;
- Organizimi i aktiviteteve të praktikës profesionale, në bashkëpunim me ndërmarrjet publike dhe private;
- Implementimi i Protokollit për parandalimin dhe referimin e akteve të dhunës në arsimin parauniversitar;
- Shfrytëzimi i sigurt i internetit në shkolla;
- Bashkëpunimi i Zyrës për siguri në shkolla me drejtoritë dhe mekanizmat tjerë komunal dhe qendror;
- Sigurimi i të dhënave për planifikimin e buxhetit;
- Përgatitja e tenderëve për mallra dhe shërbime;
- Përgatitja e lëndëve për mallra dhe shërbime;
- Përcjellja dhe realizimi i projekteve nga Banka Botërore;
- Evidentimi i të hyrave vetanake;

- Nënaloqimet e pagave për institucionet shkollore;
- Nënaloqimet e mjeteve për mallra dhe shërbime në nënprograme;
- Shpenzimet komunale për institucionet shkollore;
- Pranimi i lëndëve për aprovim;
- Zotimi i lëndëve;
- Aprovimi i pagesave;
- Barazimi i pagesave me freebalance;
- Sigurimi i sistemit të komunikimit në mes të DKA-së dhe shkollave;
- Fuqizimi i Zyrës për siguri në shkolla;
- Përdorimi i Regjistrit të rasteve të dhunës;
- Shpallja e konkursit për bursa për studentët e komunës së Prishtinës;
- Vlerësimi i aplikacioneve për dhënien e bursave;
- Vlerësimi i tenderit për inventarizimin e shkollës në lagjen “Arbëria”;
- Fillimi i procedurave të prokurimit për inventarizimin të aneksit të shkollës fillore “Faik Konica”;
- Vlerësimi i tenderit “ Furnizimi me pajisje muzikore i kabineteve të muzikës”;
- Përfundimi i procedurave të prokurimit për tenderin “ Furnizimi me inventar për aneksin e shkollës fillore “Faik Konica”;
- Pajisja e sallave të edukatës fizike me rekuizita sportive;
- Pajisja e aneksit të shkollës fillore “Faik Konica”, me inventar të nevojshëm;
- Fillimi i procedurave për tenderin “Furnizimi me pajisje muzikore i kabineteve të muzikës”;
- Furnizimi i institucioneve parashkollore me mjete didaktike dhe rekuizita;
- Furnizimi i shkollave me pako minimale të mjeteve të konkretizimit, përfshirë pajisjet laboratorike;
- Furnizimi me inventar i çerdhes në lagjen “Tophane”;
- Funkcionalizimi dhe vendosja e kutive të ankesave në institucionet edukativo-arsimore;
- Furnizimi i të gjitha institucioneve të nivelit parauniversitar me inventar shkollor;
- Fillimi i implementimit të projektit “Furnizimi me kënde të leximit të bibliotekave shkollore”;
- Furnizimi me material higjienik i institucioneve arsimore, në baze të kërkesave, në mënyre sistematike;
- Furnizimi i bibliotekave shkollore me libra;
- Furnizimi sistematik i institucioneve arsimore me naftë, dru dhe pelet për ngrohje;
- Furnizimi i institucioneve arsimore të nivelit fillor (I-V) me kiflet dhe qumësht;
- Pajisja e bibliotekave shkollore me literaturë profesionale, tekste mësimore dhe libra (bashkëpunim me bibliotekat në nivel komune dhe vendi, me komunitetin);
- Inventar për institucione arsimore (kënde leximi);

2. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e Drejtorisë.

- Mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor, është duke u realizuar në vazhdimësi nga zyrtarët e arsimit;
- Sipas dinamikës së planifikuar, zyrtarët e arsimit kanë realizuar planin operues, si: vizita informuese, speciale, kontrolluese dhe të përgjithshme në institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar. Në kuadër të mbikëqyrjes profesionale dhe kontrollit të vazhdueshëm të ecurive dhe zhvillimeve në procesin e institucioneve edukativo-arsimore të Komunës së Prishtinës, zyrtarët e Drejtorisë së Arsimit sipas planifikimit dhe dinamikës së paraparë gjatë vitit 2017, kanë realizuar vizita me karakter të ndryshëm në institucionet arsimore;
- Zyrtarët e lartë të arsimit, gjatë vitit 2017, kanë realizuar mbi **110 vizita informuese** në institucionet edukativo-arsimore, **33 vizita kontrolluese**, **35 vizita të përgjithshme** dhe **27 vizita speciale** në institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar. Zyrtarët e arsimit gjatë realizimit të vizitave nëpër shkolla, kanë kontrolluar dokumentacionin pedagogjik dhe planprogramet mësimore, kanë monitoruar punën e mësimit të nxënësve sipas planit, mbështetur në kapacitetet e drejtorisë, kanë kontrolluar objektet shkollore dhe funksionalitetin e tyre, kanë përcjellë shkallën e vijueshmërisë së nxënësve, mësimit të punësuarve tjerë nëpër shkolla. Kanë përcjellë shkallën e funksionimit të organeve profesionale dhe administrative të institucioneve shkollore, shkallën e bashkëpunimit me prindër, me institucionet tjera dhe shoqërinë civile. Ky shërbim ka analizuar vlerësimin e shkallës së arritshmërisë së nxënësve në mësim sipas periodave mësimore. Janë bërë vlerësimet dhe janë dhënë propozim-masat për përmirësime eventuale, sipas nevojës;
- Drejtoria e Arsimit në koordinim me përfaqësuesit e GIZ-it, për t'i ndihmuar drejtorët e institucioneve edukativo-arsimore kanë organizuar punëtori për implementimin e Udhëzimit të ri për planin zhvillimor të shkollës, duke i këshilluar për mënyrën e plotësimit dhe bartjen e të dhënave nga formati i vjetër në të riun. Projekti i Bankës Botërore së shpejti do të fillojë me dhënie të granteve për shkolla dhe një nga kushtet do të jetë që shkolla të ketë PZSHH në formatin e ri, andaj shkollat do të jenë të gatshme të konkurrojnë për grante.

- Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës, në vazhden e aktiviteteve të shumta në funksion të zhvillimit dhe përmirësimit të cilësisë në arsim, më 10 shkurt 2017, organizoi garën “Olimpiada matematike” në nivel komune.

Në këtë garë morën pjesë 107 nxënës të klasave IX-XII nga të gjitha institucionet edukativo-arsimore publiko dhe private.

Në Olimpiadën matematike, secila shkollë u përfaqësua me nxënës që treguan rezultate të larta në nivel shkolle. Nxënësit që do shënojnë rezultate të mira në nivel komune, do e përfaqësojnë Komune e



Prishtinës në nivel vendi, më 25 shkurt 2017, dhe pastaj në nivel ndërkombëtar prej datës 12-23 korrik 2017, e që në këtë vit do të mbahet në Brazil.

Në vitin 2016, nxënësit e komunës së Prishtinës në Olimpiadën e Matematikës në nivel ndërkombëtar, treguan rezultate të larta, garë e organizuar në Hong Kong, duke u shpërblyer me medalje dhe mirënjohje, ndërsa për vitin 2017, i urojmë nxënësit për rezultate dhe suksese më të larta.

Po ashtu, duhet theksuar se kontribut të çmueshëm dhe profesional në procesin e organizimit të Olimpiadës së Matematikës, kanë dhënë mësimdhënësit e lëndës së matematikës, të cilët kanë dorëzuar pyetje, nga të cilat më pas, drejtoria ka realizuar përpilimin e testeve.



Gjithë ecuria dhe procesi i testimit është administruar dhe monitoruar nga zyrtarët e Drejtorisë së Arsimit dhe mësimdhënësit e matematikës;


- **Rezultatet përfundimtare të OMK-së, në nivel vendi**

Nxënësit e komunës së Prishtinës të nivelit të arsimit parauniversitar, në garën e Olimpiadës matematike të Kosovës, të organizuar në nivel vendi, më 25 shkurt 2017, arritën rezultate të larta, duke fituar 67 për qind të vendeve të para në nivel vendi. Këto rezultate janë tregues se cilësia e arsimit në komunën e Prishtinës, është duke shënuar progres të theksuar nga viti në vit, kjo është si rezultat i punës së gjithë

akterëve të përfshirë në procesin edukativo-arsimor dhe përmirësimi i kushteve sipas standardeve për një mësimdhënie dhe mësimnxënie cilësore.

Këtyre matematicientëve të rinj ju urojmë shumë suksese edhe në garën në nivel ndërkombëtar, që këtë vit do të mbahet në Brazil, nga data 12 deri 23 korrik 2017.

REZULTATET PËRFUNDIMTARE TË OLIPIADËS MATEMATIKE TË KOSOVËS NË NIVEL VENDIT - 2017										
KLASA-IX										
Nr.	Emri	Mbiemri	Komuna	Det 1	Det 2	Det 3	Det 4	Det 5	Gjithsej-pikë	Vendi
1	Bardh	Osmani	Gjilan	20	11	20	20	20	91	Vendi-I
2	Anesa	Gashi	Prishtinë	20	14	20	18	2	74	Vendi-II
3	Lorik	Ramosaj	Deçan	8	15	20	2	0	45	Vendi-III
KLASA-X										
1	Kajtaç	Gjema	Prishtinë	20	20	19	9	5	73	Vendi-I
2	Arbesa	Kadriu	Prishtinë	20	20	20	0	7	67	Vendi-II
3	Gramos	Nikçi	Pejë	20	20	20	2	0	62	Vendi-III
KLASA-XI										
1	Besfort	Shala	Prishtinë	20	0	20	20	0	60	Vendi-I
2	Albion	Krasniqi	Prishtinë	20	0	5	20	0	45	Vendi-II
3	Jona	Zeneli	Lipjan	20	7	0	5	0	32	Vendi-III
KLASA-XII										
1	Shend	Zhjeqi	Prishtinë	20	18	20	20	20	98	Vendi-I
2	Erion	Hamiti	Prishtinë	0	0	20	20	20	60	Vendi-II
3	Alban	Elezi	Prishtinë	2	9	0	20	20	51	Vendi-III



- Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës, në vazhden e aktiviteteve dhe garave të shumta, në funksion të zhvillimit dhe përmirësimit të cilësisë në arsim, më 12 maj, organizoi garën e diturisë-“Prishtina 2017”, garë e realizuar në tetë lëndë të shkencave natyrore dhe shoqërore në: gjuhë shqipe dhe letërsi, gjuhë angleze, matematikë, fizikë, kimi, biologji, histori dhe në lëndën e gjeografisë.



Gara është organizuar dhe zhvilluar me nxënësit e nivelit të arsimit të mesëm të ulët, konkretisht nxënësit e klasave të nënta (IX), ku pjesëmarrës ishin **335 nxënës**, të shkollave publike dhe private, të cilët përfaqësuan shkollën në nivel komune, pasi kishin treguar rezultate të larta në shkollat e tyre.

Testi dhe gjithë procesi i garës së diturisë “Prishtina 2017” u administrua dhe monitorua nga zyrtarët e Drejtorisë së Arsimit, si dhe mësimdhënësit e fushave të ndryshme.

Qëllimi dhe organizimi i garës me karakter të tillë, është përmirësimi i cilësisë në arsim, identifikimin e talenteve të reja, nxjerrja në pah e shkathtësive të tyre, kompetencave të arritura në shkencat natyrore-shoqërore dhe mbështetjen e tyre drejt avancimit dhe zhvillimit profesional.

Drejtoria e Arsimit në zhvillimin dhe ngritjen e cilësisë në arsim, ka ndër marrë veprime konkrete në shumë dimensione që garantojnë progres në ngritje të cilësisë, duke përmirësuar infrastrukturën shkollore, pajisjen e shkollave me kabinete, laboratorë dhe mjete të ndryshme, organizimin e vazhdueshme të trajnimeve të ndryshme në bashkëpunim me



Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe organizata joqeveritare, për ngritjen dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve, në mënyrë që të kemi një mësimdhënie cilësor dhe të jemi në hap me trendet ndërkombëtarë, pra duke krijuar

kushte të favorshme për mësimdhënie dhe mësim-nxënie të standardeve bashkëkohore.

- Rezultatet finale të arritura në garën e diturisë “Prishtina 2017”, nga nxënësit e nivelit të arsimit të mesëm të ulët

REZULTATET PËRFUNDIMTARE TË GARËS SË DITURISË - "PRISHTINA 2017"				
19 maj 2017				
GJUHË SHQIPE				
Nr.	Emri i shkollës	Emri dhe Mbiemri	Pikët	Vendi
1	SHFMU "Shkëndija"	Rinesa Makolli	80	I
2	SHFMU "Iliria"	Erza Osmani	76	II
3	SHFMU "Emin Duraku"	Rinesa Sylejmani	74	III
GJUHË ANGLEZE				
Nr.	Emri i shkollës	Emri dhe Mbiemri	Pikët	Vendi
1	SHFMU "Pjetër Bogdani"	Drilon Aliu	97	I
2	SHFMU "Gjergj Fishta"	Blerta Dobërdolani	90	II
3	SHFMU "Naim Frashëri"	Blin Ahmeti	88	III
4	SHFMU "Hasan Prishtina"	Viola Bugaçku	88	III
5	SHFMU "Asim Vokshi"	Diellza Ibrahimimi	88	III
6	SHFMU "Pavarësia"	Erzana Uka	88	III
HISTORI				
Nr.	Emri i shkollës	Emri dhe Mbiemri	Pikët	Vendi
1	SHFMU "Nexhmi Mustafa"	Donjeta Sejdiu	82	I
2	SHFMU "Faik Konica"	Jorida Troshupa	64	II
3	SHFMU "Hasan Prishtina"	Stinë Osmani	63	III
GJEOGRAFI				
Nr.	Emri i shkollës	Emri dhe Mbiemri	Pikët	Vendi
1	SHFMU "Filip Shiroka"	Donjeta Zeqiri	70	I
2	SHFMU "Faik Konica"	Dina Bashota	61	II
3	SHFMU "Afrim Gashi"	Rifat Gashi	60	III
MATEMATIKË				
Nr.	Emri i shkollës	Emri dhe Mbiemri	Pikët	Vendi
1	SHFMU "Meto Bajraktari"	Anesa Gashi	68	I
2	ISP	Dren Neziri	65	II
3	SHFMU "Xhemail Mustafa"	Erna Hulaj	41	III
4	SHFMU "Pavarësia"	Sherif Hoti	37	IV

FIZIKË				
Nr.	Emri i shkollës	Emri dhe Mbiemri	Pikët	Vendi
1	SHFMU "Meto Bajraktari"	Gent Skenderi	74	I
2	SHFMU "Qamil Batalli"	Djellza Pervetica	66	II
3	SHFMU "Nazim Gafurri"	Diamant Bekteshi	63.5	III
KIMI				
Nr.	Emri i shkollës	Emri dhe Mbiemri	Pikët	Vendi
1	SHFMU "Shkolla e Gjelbërt"	Blend Krasniqi	83	I
2	SHFMU "Xhavit Ahmeti"	Erona Kelmendi	78	II
3	SHFMU "Afrim Gashi"	Suzana Tërnavë	76	III
BIOLOGJI				
Nr.	Emri i shkollës	Emri dhe Mbiemri	Pikët	Vendi
1	SHFMU "Xhemail Mustafa"	Buliza Duriqi	77	I
2	SHFMU "Faik Konica"	Elma Shatri	77	I
3	SHFMU "Andon Z.Çajupi"	Blertina Islami	75	II
4	SHFMU "Dardania"	Era Gërbeshi	75	II
5	SHFMU "Naim Frashëri"	Ema Kutlovci	72	III

- Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës, më 28 korrik organizoi pritjen për nxënësit pjesëmarrës të garës "Olimpiada Ndërkombëtare e Matematikës", që këtë vit u organizua në Brazil.

Pritja u realizua nga drejtoresha e Drejtorisë së Arsimit, znj. Arbërie Nagavci, zyrtarët e arsimit, drejtori i shkollës, mësime dhënësit dhe shokët e shkollës. Në këtë garë të nivelit ndërkombëtar, ku morën pjesë pothuajse të gjitha vendet e botës, në mesin e tyre ishin dy nxënës nga komuna e Prishtinës, Shend Zhjeqi dhe Alban Elezi, të cilët e përfaqësuan Republikën e Kosovën në mënyrë dinjitoze.



Shend Zhjeqi, nxënës i gjimnazit Matematikë në Prishtinë, pas shkathtësive dhe kompetencave të jashtëzakonshme të treguara në Olimpiadën matematike të Kosovës në nivel komune dhe në nivel Republike, arriti të triumfojë edhe në nivelin ndërkombëtar, duke fituar medaljen e bronzë në garën “Olimpiada Ndërkombëtare Matematike” (ONM).



Drejtoria e Arsimit për ngritjen dhe përmirësimin e cilësisë në arsim, në mënyrë të vazhdueshme organizon gara të ndryshme në nivel komune. Po ashtu, në funksion të zhvillimit të përmirësimit të cilësisë në arsim,

Drejtoria e Arsimit, në bashkëpunim edhe me Shoqatën e Matematicientëve, për çdo vit organizojnë garën “Olimpiada matematike”, në nivel komune dhe Republike, garë e cila po nxjerr në pah talentet e matematikës.



Drejtoria e Arsimit, nga fillimi i funksionimit të gjimnazit Matematikë në vitin 2014, ka hasur në vështirësi dhe sfida të mëdha, sepse Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ende nuk ka ndarë buxhet për funksionimin e këtij gjimnazi.

Përkundër peripecive të shumta, Drejtoria e Arsimit ka arritur t’i tejkalojë sfidat e paraqitura në gjimnazin Matematikë, duke e mbuluar dhe siguruar me staf të brendshëm dhe kushte të domosdoshme për funksionim e këtij institucioni, duke siguruar një proces me mësimdhënie dhe mësimnxënie cilësore sipas standardeve bashkëkohore.

Për rezultatet e arritura në garën “Olimpiada Ndërkombëtare e Matematikës”, një falënderim i veçantë shkon për mësimdhënësit, kontributin e tyre të çmuar, dhe Shoqatën Matematike të Kosovës.



Për arritjet e tyre, Shend Zhjeqi u shpërblye me çmimin prej 500 €, ndërsaq Alban Elezi me 200 euro.

- **Program festiv për nder të 7 Marsit - Ditës së Mësuesit**

Drejtorja e Arsimit e Komunës së Prishtinës, në kuadër të aktiviteteve për shënimin e 130 vjetorit të mësonjëtores së parë shqipe, organizoi pritje për veteranë të arsimit, përfaqësues të shkollave të Prishtinës, si dhe organizoi program kulturo-artistik për nder të kësaj dite historike të arsimit shqip.

Në shënimin e kësaj ngjarjeje historike, drejtoresha e Arsimit, znj. Arbërie Nagavci, diskutoi për peshën dhe rëndësinë që ka kjo ditë për arsimin e kombit tonë dhe rolin mësimdhënës në veçanti, duke potencuar se detyra e mësimdhënësit është patriotike dhe kombëtare, për shkak të përgjegjësisë që kanë për edukimin dhe arsimimin e gjeneratave. “Rruga përpara na kërkon përkushtim edhe më të madh. Vazhdoni me punë të mbarë, ashtu që të jeni shembull i mirë për nxënësit tuaj. Kjo nuk është punë e lehtë, por është punë fisnike, që përcillet me krenari pas sukseseve të arritura”, tha ndër të tjera znj. Nagavci.

Kryetari i Komunës, z. Shpend Ahmeti, potencoi se 7 Marsi është ditë falënderimi për mësimdhënëset, të cilët tërë jetë e tyre ia kushtojnë shërbimit ndaj popullit, me qëllimin e vetëm që dijen e vet ta bartin tek gjeneratat tjera. “Ne duhet të punojmë që t’ua kthejmë dinjitetin mësimdhënësve, sepse nga gjeneratat që nxjerrin ata sot, do ta dimë se ku do të jemi pas 15-20 vjetëve. Që të kemi shansin më të vogël për zhvillim, prioritet kryesor duhet ta kemi arsimin, si në nivel lokal ashtu edhe në nivel qendror”, u shpreh z. Ahmeti.

Komuna e Prishtinës ndau mirënjohje për veteranët e arsimit të moshës nga 75 deri në 79 vjeç, si Nadire Skenderi, Fikrije Ukelli, Meliha Jaka, Nasuf Krasniqi, Hasan Jashari, Miradie Hamiti, Shukrije Selimi, Miftar Oraca, Nesrete Kasumi, Ganimete Hundozi, Hafiz Gashi, Hatixhe Hajdini, Shenasje Kelmendi, Sebiha Orana, Nuhi Haxhiu, Bejtush Gerbeshi, Ajvaz Abazi, Melihate Brada, Ilaz Berisha, Shemsie Shala, Nasibe Gacaferri, Qerkin Makolli, Imrane Shuku, Mukadeze Ballata,



Azem Veseli, Sebahate Bunjaku, Ibrahim Geci, Jetullah Krasniqi, Feim Masurica, Mirvete Vula, Naile Berbati, Xhemajlie Hoxha, Ajtene Pllana, Veronika Mjeda, Hadije Gjinali, Selim Ballata, Letafet Ballata, Pasionaria Nimani, Shqipe Emra, Ana Gjini dhe Murat Osmanaj. Në fund të këtij organizmi, me mirënjohje u nderuan edhe mësime dhe mësuesit e dalluar aktualë, si Hazbije Jasiqi, Afëridta Hajdari - Hoxha, Hidajete Hoxha, Sadije Mehmeti dhe Shefqet Thaqi.



- **Gara e inteligjencës “EUREKA 4” - 2017**

Nxënësit e komunës së Prishtinës, në çdo garë dhe aktivitet të organizuar në nivel vendit janë duke treguar rezultate dhe sukses të larta. Në Garën e Inteligjencës “EUREKA-4” e organizuar nga gjimnazi “Hasan Nahi”, në kuadër të Fondacionit për Arsim dhe Kulturë “ATMOSFERA”, e mbështetur edhe nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, drejtoritë komunale të arsimit dhe shkollat e nivelit të arsimit parauniversiter në nivel vendit, nxënësit e komunës së Prishtinës triumfuan me rezultate të larta.



Në këtë garë sivjet u sfiduan mbi 2000 nxënës të dalluar të klasave të nënta (IX) nga gjithë institucionet edukativo-arsimore të Republikës së Kosovës, por suksese dhe rezultate të larta tregoi nxënësja Erna Hulaj, nxënëse e shkollës fillore "Xhemail Mustafa" në Prishtinë, duke fituar vendin e parë në Garën e inteligjencës “EUREKA 4” për vitin 2017.

- **Gara e fizikanëve të rinj**

Me 19 prill 2017, Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës organizoi garën e radhës, “Fizikanët e rinj” në nivel komune. Gara u zhvillua në objektin e gjimnazit Matematikë, ku pjesëmarrës ishin 75 nxënës të nivelit të arsimit të mesëm të ulët, konkretisht nxënësit e klasave të nënta (IX) dhe nxënësit e nivelit të arsimit të mesëm të lartë të klasave X, XI dhe XII, nga të gjitha institucionet edukativo-arsimore.



Në garën e fizikanëve të rinj, secila shkollë u përfaqësua me nxënës që kanë treguar rezultate të larta në garën në nivel shkolle. Ndërsa, nxënësit që do të shënojnë rezultate të mira në nivel komune do të përfaqësojnë Komunën e Prishtinës në nivel vendi, më 29 prill, garë kjo që do të mbahet në Fakultetin e Shkencave Matematikore-Natyrore (Departamentin e Fizikës), të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina".



Qëllimi dhe organizimi i garës me karakter të tillë, është në funksion të përmirësimit të cilësisë në arsim, nxjerrjes në pah të shkathtësive dhe

kompetencave të arritura nga nxënësit në shkencën e fizikës, identifikimin e talenteve të reja dhe mbështetjen e tyre drejt avancimit dhe zhvillimit profesional.

Drejtoria e Arsimit, në kontekst të zhvillimit, ngritjes dhe përmirësimit të cilësisë në arsim, ka ndërmarrë veprime konkrete në shumë dimensione që garantojnë progres në ngritje të cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie, duke përmirësuar infrastrukturën shkollore, pajisjen e shkollave me kabine, laboratorë dhe mjete të ndryshme dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve, në mënyrë që të kemi një mësimdhënie cilësor dhe të jemi në hapë me trendet ndërkombëtare.



Në procesin e organizimit të garës "Fizikanët e rinj", kontribut të çmueshëm dhe profesional kanë dhënë mësimdhënësit e lëndës së fizikës, të cilët kanë dorëzuar pyetje, nga të cilat më pas drejtorja ka realizuar përpilimin e testeve.

Gjithë ecuria dhe procesi i testimit është administruar dhe monitoruar nga zyrtarët e Drejtorisë së Arsimit dhe mësimdhënësit e fizikës;

- Nxënësit e Komunës së Prishtinës, pas shkathtësive dhe kompetencave të larta që treguan në garën "Fizikanët e rinj", të organizuar në nivel komune, më 19 prill 2017, triumfuan edhe në garën e mbajtur në nivel vendi, më 29 prill, duke siguruar vendet e para:

REZULTATET PËRFUNDIMTARE TË GARËS "FIZIKANËVE TË RINJ" NË NIVEL REPUBLIKE - 2017				
Nr.	Emri dhe Mbiemri	Shkolla	Klasa	Vendi
1	Gent Skenderi	SHFMU "Meto Bajraktari"	IX	Parë (I)
2	Tringa Syla	Gjimnazi "Sami Frashëri"	XI	Parë (I)
3	Lejla Gusinac	Gjimnazi "Xhevdet Doda"	XII	Parë (I)

- **“Shkencëtari i ri”**

Në vazhden e aktiviteteve të shumta në funksion të ngritjes dhe përmirësimit të cilësisë së arsimit, në veçanti ngritjes së cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie, Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, më 21 prill 2017, organizuan garën **“Shkencëtari i ri”**, në objektin e gjimnazit Matematikë.



Ky format i garës u organizua vetëm me nxënës të gjimnazeve: “Sami Frashëri”, “Ahmet Gashi”, “Alauddini” dhe “Xhevdet Doda”, ku pjesëmarrës ishin 42 nxënës të klasave X, XI dhe të XII, të cilët pasi kanë treguar rezultate të larta në garat e zhvilluara në shkollat e tyre, iu nënshtruan testit në nivel komune në lëndën e kimisë dhe biologjisë.

Qëllimi dhe organizimi i garës me karakter të tillë, është identifikimi i talenteve të reja, nxjerrja në pah e shkathtësive të tyre dhe njëkohësisht mbështetja e tyre drejt avancimit dhe zhvillimit profesional.



Drejtoria e Arsimit dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në këtë segment kanë hartuar strategji dhe politika stimuluese, në mënyrë që nxënësit që do tregojnë rezultate dhe suksese të larta të kenë mbështetje (shpërblime).

Përmes këtyre aktiviteteve garuese dhe politikave stimuluese për nxënësit të suksesshëm, synohet nxitja e tyre për të garuar në sferën e dijes dhe për t'i përmirësuar rezultatet.

Drejtoria komunale e Arsimit po punon në mënyrë të vazhdueshme për krijimin e kushteve sipas standardeve bashkëkohore për mësimdhënie dhe mësimnxënie cilësore, me qëllim që cilësia, rezultatet dhe suksesi në shkollat tona të shënojë progres dhe të arrijnë në nivelin e shkollave të përparuara;



- **Olimpiada matematike**

Në funksion të zhvillimeve progresive në sistemin e arsimit, më 23 dhjetor 2017, Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës, në bashkëpunim me Shoqatën e Matematikanëve të Kosovës, organizuan garën "Olimpiada matematike", garë e cila ka për qëllim nxjerrjen në pah të shkathtësive dhe kompetencave të nxënësve të arritura në shkencën e matematikës, identifikimin e talenteve të reja dhe mbështetjen e tyre drejt avancimit dhe zhvillimit profesional.



Pjesëmarrës në këtë garë ishin 116 nxënës të klasave IX-XII nga të gjitha institucionet edukativo-arsimore publiko dhe private. Në këtë garë secila shkollë u përfaqësua me nxënës që treguan rezultate të larta në nivel shkolle. Nxënësit që do shënojnë rezultate të mira në nivel komune, do të përfaqësojnë Komune e Prishtinës në nivel vendi, më 27 janar 2018 dhe në nivel ndërkombëtar prej datës 03-14 korrik 2018, e që këtë vit do të mbahet në Rumuni.



Nxënësit e Komunës së Prishtinës në Olimpiadën e matematikës në nivel ndërkombëtar, të organizuar në Brazil në korrik të vitin 2017, treguan rezultate të larta, duke triumfuar mbi shtetet më të fuqishme të botës dhe duke fituar medaljen e bronzte dhe mirënjohje, ndërsa për vitin 2018, urojmë që sukseset dhe rezultatet të jenë edhe më të larta.



Njëherësh falënderojmë mesimdhënësit e matematikës për kontributin e tyre profesional në këtë proces, në veçanti drejtorin e shkollës "Dardania", për mbështetjen në organizimin dhe realizimin e kësaj gare.


- **Testi i arritshmërisë**

Më 26 maj 2017, në autoritetin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe drejtorive komunale të arsimit, u organizua "Testi i arritshmërisë" në nivel vendi, me nxënësit e klasave të nënta (IX). Këtij testit në komunën e Prishtinës iu nënshtruan 3703 nxënës.

Drejtoria e Arsimit për një proces të drejtë dhe të standardizuar, ka ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme, duke organizuar testin në njëmbëdhjetë (11) qendra, me qëllim të krijimit të kushteve dhe standardeve më të mira për punë, gjë që ka reflektuar pozitivisht në mbarëvajtjen e testit dhe shpresojmë edhe në rezultate më të mira dhe reale.

Për një proces të mirëfilltë të testimit dhe vlerësimit të standardizuar, ka realizuar formën e organizimit të "Testit të arritshmërisë", një nxënës një bankë, dhe kjo formë ka reflektuar pozitivisht në ecurinë dhe cilësinë e këtij procesi.

Në funksion të këtij procesit, të gjithë akterët e përfshirë në ecurinë dhe mbarëvajtjen e Testit të arritshmërisë, i kanë realizuar punët dhe detyrat me përgjegjësi të lartë, duke mundësuar që të kemi një proces të drejtë dhe me rezultate reale dhe objektive. Drejtoria e Arsimit për një proces të drejtë dhe të standardizuar, ka ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme, duke organizuar Testin e arritshmërisë në njëmbëdhjetë (11) qendra, me qëllim të krijimit të kushteve dhe standardeve më të mira për punë, gjë që ka reflektuar pozitivisht në mbarëvajtjen e testit dhe në rezultate objektive dhe reale.



- Realizimi i analizës dhe vlerësimit të përgjithshëm, mbi suksesin dhe rezultatet e arritura nga nxënësit e të tri nivelet e arsimit parauniversitar gjatë gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2016/17;
- Realizimi i analizës dhe vlerësimit mbi suksesin e arritur në secilën lëndë në të tri nivelet e arsimit parauniversitar gjatë gjysmëvjetorit të dytë;
- Përfundimi i suksesit lëndor për shkollat e mesme;
- **Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës** në funksion të përmirësimit dhe

ngritjes së cilësisë në arsim, organizoi takim pune me drejtues të institucioneve edukativo-arsimore të nivelit të arsimit parauniversitar dhe me kryetarët e aktiveve profesionale të të gjitha shkollave të Komunës së Prishtinës. Në këtë takim morën pjesë mbi 600 përfaqësues nga të gjitha shkollat, të cilët jo vetëm se mirëpritën këtë bashkëpunim, adresuan çështje me interes për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe shprehën gatishmëri për angazhim të vazhdueshëm në drejtimin e ngritjes së cilësisë në arsim.



Drejtoresha e Arsimit, znj. Arbërie Nagavci, në fjalën e saj deklaroi se "rikthimi në cilësinë e plotë të arsimimit në Kosovë, është një aksion shtetëror dhe kombëtar". Ky aksion kërkon edhe sakrificë, edhe dije. Shumë zyrtarë apo dhe profesionistë, kam parë që të jenë të vendosur për të dyja. Duke qenë të vetëdijshëm për sfidat dhe peripecitë e mëdha që janë duke e përcjellë sistemin e arsimit në Republikën e Kosovës në tri nivelet e arsimit parauniversitar, kërkoj një bashkëpunim dhe mobilizim të përgjithshëm, në funksion të përmirësimit dhe ngritjes së cilësisë në arsim, me qëllim të arritjes së rezultateve të niveleve dhe standardeve bashkëkohore e të qëndrueshme.



Vlerësimet e jashtme, në veçanti vlerësimi ndërkombëtar PISA, e radhiti Kosovën ndër vendet e fundit sa i përket rezultateve, në të tri fushat e përfshira në vlerësim (lexim, matematikë dhe shkencë) krahasuar me të gjitha vendet dhe ekonomitë tjera pjesëmarrëse. Madje jo vetëm ndër të fundit, por shumë larg nën mesataren e përgjithshme dhe mjaft nën mesataren edhe të Republikës së Shqipërisë, duke përmbysur kështu dhe rezultatet e brendshme të shkollave, si jo të standardizuara dhe të paqëndrueshme.

Për të dalë nga kjo situatë nevojitet mobilizim i të gjithë neve dhe sidomos i organeve profesionale në shkolla, për realizimin e punëve dhe detyrave me profesionalizëm dhe përgjegjësi të lartë.”

Drejtorja e Arsimit, duke e ditur peshën dhe rëndësinë determinuese që kanë organet profesionale të shkollës në zhvillimin dhe përmirësimin e cilësisë në arsim, kërkon që tani e tutje secili organ t'i realizojë punët dhe detyrat me përgjegjësi të lartë. Andaj, tani e tutje drejtuesit e shkollave do veprojnë në koordinim të plotë me organet profesionale të shkollës, duke ndërmarrë të gjithë hapat e duhura për përmirësimin e cilësisë së arsimit në shkollën e menaxhuar nga ta, bashkërisht me Komunën e Prishtinës dhe me kontribut edhe më gjerë;



- Më 16 shkurt 2017, Drejtorja e Arsimit e Komunës së Prishtinës, në bashkëpunim me Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", kanë hapur ekspozitë për nder të 9-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës.

Ekspozita është organizuar dhe zhvilluar në objektin e Galerisë së Fakultetit të Arteve. Në këtë ekspozitë u prezantuan punimet e realizuar nga nxënësit e nivelit të arsimit parauniversitar të komunës së Prishtinës.



Planifikimi dhe organizimi i ekspozitës është realizuar në koordinim edhe me drejtuesit e Fakultetit të Arteve dhe drejtuesit e institucioneve edukativo-arsimore dhe ka qëndruar e hapur për vizitorët nga data 16 deri më 19 shkurt 2017.

Në këtë ekspozitë, secili institucion edukativo-arsimore është përfaqësuar me nga tre-katër punime, të punuar nga nxënësit e shkollave të tyre.

Qëllimi i këtij aktiviteti, pos shënimit të 9-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, ekspozimit të punimeve të nxënësve, ishte edhe identifikimi i talenteve të reja, nxjerrja në pah e shkathtësive e kompetencave të tyre dhe mbështetja e tyre drejt avancimit dhe zhvillimit profesional në fushën e artit.



- Drejtorja e Arsimit, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, për nder të “Festës së Abetares”, organizuan program festiv me karakter mbarëkombëtar. Në shënimin e kësaj feste morën pjesë të gjitha rajonet e Kosovës dhe trevat shqiptare jashtë kufijve, si: Shqipëria, Lugina e Preshevës dhe Maqedonia. Festa e Abetares është organizim tradicional dhe ka karakter lëvizës, duke u mbajtur edhe në qendrat e mëdha të Kosovës, ndërsa këtë vit ceremonia u mbajti në kryeqendër të Kosovës.

Historiku i abetares së parë në gjuhën shqipe daton nga vitit 1844, kur personaliteti i shquar i Rilindjes



Kombëtare, Naum Veqilharxhi, hartoi abetaren me titull "**Fort i shkurtër e i përdorshëm Evetar shqip**".

Hartimi dhe realizimi i kësaj abetareje e vuri Shqipërinë në radhën e vendeve të qytetëruara, duke treguar se ky vend ka një popull me karakteristikat e tij, me gjuhën dhe zakonet e veta dhe me një thesar të trashëguar nga brezat.



Abetaret ishin arma nga më të fuqishmet dhe më të efektshmet për të shpëtuar arsimin tonë, për të ecur drejt dritës e diturisë, apo siç thotë i madhi Naim Frashëri "**Vetëm dritë e diturisë do na shpije përpara**". Për ta mbajtur gjallë të freskët abetaren shqiptare, djersën, mundin e intelektin e tyre e derdhën edhe shumë intelektualë të fuqishëm të kohës, si: Konstandin Kristoforidhi, Jani Vreto, Pashko Vasa, vëllezërit Frashëri, Luigj Gurakuqi e shumë e shumë të tjerë.

Botimi i Abetares së parë hapi një faqe të re të historisë së gjuhës sonë, nga ajo kohë kanë kaluar plot 173 vjet dhe, deri më sot janë shtypur më se 150 abetare në trevat shqiptare dhe jashtë tyre, e cila vazhdimisht është përsosur. Viti 2012, ishte vit i kurorëzimit të abetarës së përbashkët për shqiptarët e andej e këndej Drinit, ishte vit kur 36 filigranët e shkronjave të Naum Veqilharxhit u përruan në ar në qytetin historik të Prizrenit.

- Drejtorja e Arsimit e Komunës së Prishtinës, për të dytën herë me radhë organizon ceremoninë madhështore të diplomimit për të gjithë maturantët e shkollave të mesme të larta publike të komunës së Prishtinës.

Organizimet ceremoniale të diplomimit u zhvilluan në amfiteatrin e Gërmisë, duke filluar më 24 maj, deri më 15 qershor, për 3110 maturantë të të gjitha shkollave të nivelit të arsimit të mesëm të lartë.



Për të kremtuar këtë ditë të veçantë, nxënësit e shkollave prezantuan program të pasur artistik, ku ndër të tjera

shfaqin momentet më të bukura të tyre përgjatë këtyre tri viteve të shkollimit. E pranishme në këto ceremoni ishte edhe drejtoresha e Drejtorisë komunale të Arsimit, znj. Arbërie Nagavci dhe zyrtarët e arsimit.

Znj. Nagavci në fjalën e rastit në të kësaj ceremonie theksoi se është kënaqësi dhe privilegj të jesh pjesë e këtyre eventeve. Njëherësh i uroi nxënësit për përfundimin e shkollimit të mesëm të lartë dhe uroi për suksese të vazhdueshme në rrugën e dijes.

Znj. Nagavci theksoi se një falënderim të veçantë e bëri për drejtuesit e institucioneve arsimore, e në veçanti për mësimdhënësit, për punën dhe kontributin e tyre të pakontestueshëm në arsimimin dhe edukimin e gjeneratave.

Ky organizim me karakter festiv filloi me gjimnazin "Sami Frashëri", për të vazhduar me SHML "Hoxhë K. Prishtina", gjimnazin "Ahmet Gashi", gjimnazin "Xhevdet Doda" dhe gjimnazin "Matematikë".

Më 26 maj, ceremoninë e gradimit e vazhduan shkollat: SHML "Gjin Gazulli", SHML "7 Shtatori", SHML "Abdyl Frashëri", SHML "28 Nëntori", SHML "Dr. Ali Sokoli", shkolla e muzikës "Prenk Jakova" dhe gjimnazi "Eqrem Çabej", e që ishte dita përmbyllëse e kësaj ceremonie madhështore, të realizuar me 3110 maturant të të gjitha shkollave të nivelit të arsimit të mesëm të lartë.

Me rastin e diplomimit të gjeneratës 2014/17, Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës, u uron të gjithë maturantëve shëndet dhe shumë suksese në rrugëtimin e dijes, me thënien e rilindasit tonë Sami Frashëri "Mendja e një kombi është arsimi, zemra e tij – morali i përgjithshëm."



- **Komuna e Prishtinës më 13 shkurt 2017, hapi çerdhen e re me bazë në komunitet,**



në Sofali. Në këtë çerdhe deri me këtë datë janë regjistruar 30 fëmijë, dhe ka kapacitet edhe për 40 të tjerë. Kriter kryesor për regjistrim është që të jenë banorë të lagjes, me moshë nga 9 muaj deri në 6 vjeç. Edhe në këtë çerdhe, varësisht nga të ardhurave mujore që marrin të dy prindërit, Komuna do të bëjë subvencionimin e një pjese të pagesës.

Me këtë rast, Kryetari i Komunës, Shpend Ahmeti, tha: "Në vitin 2014, Prishtinën e kemi gjetur me

vetëm 7 çerdhe publike. Është bërë vlerësimi i nevojave në të gjitha lagjet dhe fshatrat e komunës së Prishtinës, dhe kemi përgatitur planin aksional për hapjen e çerdheve të reja me çmim të përballueshëm. Për 3 vjet qeverisje, janë hapur 5 çerdhe të reja. Tani po punohet për hapjen e çerdheve të reja në lagjet "Kodrën e Trimave" dhe "Tophane", me ç'rast numri i çerdheve publike në Prishtinë do të jetë dyfish më i madh sesa në fillim të mandatit";

- **Marrëveshje bashkëpunimi**

Kryetari i Komunës dhe drejtoresha e Arsimit kanë nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit në mes të Komunës së Prishtinës dhe Rrjetit të Kosovës për Arsim dhe Punësim. Marrëveshja synon hartimin e planin pesëvjeçar për arsim në Prishtinë, 2017-2021. Ky plan do të hartohet nga një ekip i specializuar, i përbërë nga zyrtarët komunalë përgjegjës për arsim, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës dhe përfaqësues të tjerë nga komuniteti shkollor dhe grupet tjera të interesit.

Në këtë mënyrë, Komuna e Prishtinës dhe organizatat e shoqërisë civile do të angazhohen së bashku për një dialog kuptimplotë, me synim përmirësimin dhe pjesëmarrjen e shoqërisë civile në procesin e zhvillimit të politikave;



- Drejtoresha e Drejtorisë së Arsimit, znj. Arbërie Nagavci, së bashku me Kryetarin e Komitetit Olimpik Kombëtar të Kosovës, z. Besim Hasani, si dhe me drejtuesen e misionit të OJQ-së "PLAY International", znj. Ana Larderet, nënshkruan marrëveshje partneriteti për projektin "Vlerat e Olimpizmit".



Projekti "Vlerat e Olimpizmit" synon ngritjen e vetëdijesimit rreth vlerave olimpike dhe të drejtat e fëmijëve përmes aktiviteteve sportive - edukuese. Projekti është i mbishkruar në kornizë të aplikimit nga Parisi për drejtimin e Lojërave Olimpike dhe Paraolimpike 2024. Projekti fillimisht do të implementohet në tetë shkolla fillore të komunës së Prishtinës, me nxënësit e moshës nëntë vjeçare, me nxënësit e kalsëve të treta të Komunës së Prishtinës.

Organizata "PLAY International" do të organizojë dhe implementojë trajnime për vullnetarët dhe mësime nxënësive, të cilët do të zhvillojnë aktivitete praktike në shkolla përkatëse. Përmes këtij projekti synohet që nxënësit e komunës së Prishtinës të integrohen në shoqëri përmes lojërave dhe aktiviteteve sportive, me qëllim të zhvillimit të diturisë dhe aftësive jetësore;

Marrëveshja e bashkëpunimit

- Drejtoresha e Drejtorisë së Arsimit, znj. Arbërie Nagavci, së bashku me drejtoreshën e misionit të OJQ-së "Terre des hommes", znj. Alketa Lasku, nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi.

Qëllim i marrëveshjes së bashkëpunimit është përmirësimi i qasjes dhe riintegrimi në arsimin fillorë të fëmijëve të riatdhesuar dhe promovimit dhe fuqizimit të mbrojtjes së të drejtave të romëve, ashkalinjve, egjiptasve dhe grupeve të tjera të cenueshme dhe për të siguruar integrimin e tyre të plotë në shoqërinë kosovare, duke pasur parasysh normat e pranuar ndërkombëtarisht të "Arsimit për të Gjithë", të drejtat e fëmijës, mbrojtjen e grupeve të cenueshme në shoqëri dhe promovimin e barazisë gjinore, në kuadër të projektit "Përmirësimi i qasjes dhe riintegrimi në arsimin fillorë të fëmijëve dhe familjeve migrantë dhe të kthyer në Kosovë".

Përmes kësaj marrëveshje do të sigurohet koordinimi dhe bashkëpunimin i plotë për mbarëvajtjen e aktiviteteve të klasëve për mësimi plotësues (KMP) në kuadër të shkollave.

Komunikim dhe koordinim të rregullt në mes drejtuesve të shkollave, mësuesve të mësimin të rregullt dhe mekanizmat e brendshëm në shkolla, mbështetur nga Tdh, me qëllim të mbështetjes së fëmijëve në vazhdimin e shkollimit dhe parandalimin e braktisjes.

Po ashtu, do të realizohen aktivitete që promovojnë pjesëmarrjen aktive dhe mbështetjen e ofruar prindërve, me qëllim të krijimit të trekëndëshit funksional në mes të mësuesve, prindërve dhe fëmijëve, për identifikimin dhe adresimin e nevojave të mbështetjes për fëmijët.

Marrëveshja e bashkëpunimit

- Drejtoresha e Drejtorisë së Arsimit, znj. Arbërie Nagavci, së bashku me drejtorin e kolegjit “Universum”, z. Alejtin Berisha, nënshkruan memorandum bashkëpunimi. Me këtë memorandum palët nënshkruese kanë shprehur vullnetin e mirë dhe gatishmërinë për bashkëpunim, duke synuar ngritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të arsimit në Kosovë, përmes përfshirjes në shkollat e komunës së Prishtinës të programeve të dramës.

Kolegji “Universum” ka blerë franshizën për Kosovë të programit më të popullarizuar në botë për drama dhe aktrim, ‘Helen O’Grady Drama Academy’. Ky program 35 vjeçar, zhvillohet në mbi 38 shtete në gjithë botën. Qëllimi i programit të Helen O’Grady Drama Academy është zhvillimi i shkathtësive të nevojshme për jetë tek fëmijët, siç është vetëbesimi, kreativiteti apo prezantimi dhe komunikimi. Bashkëngjitur me këtë memorandum, gjenden informata më të hollësishme mbi marrëveshjen e franshizës dhe informata mbi Helen O’Grady Drama Academy.

Me anë të këtij Memorandumi palët nënshkruese bashkëpunojnë në prezantimin e kurseve të Akademisë së Dramës, ‘Helen O’Grady’ nëpër shkollat fillore dhe të mesme të komunës së Prishtinës dhe pas konsultimit me këshillat drejtues të shkollave përkatëse.

- Komuna e Prishtinës ka nënshkruar Memorandum mirëkuptimi me Qendrën për Arsim të Kosovës (KEC), për të zbatuar Programin ASSET (përkrahje adoleshentëve pas mësimit të rregullt), financuar nga USAID.

Sipas këtij memorandum, palët do të punojnë në partneritet për arritjen e rezultateve në vijim:

Themelimin e “Qendrës për karrierë dhe ndërmarrësi” në gjimnazin “Xhevdet Doda”, e cila do të shfrytëzohet për aktivitete në lidhje me edukimin për karrierë dhe ndërmarrësi dhe zhvillimin e rezultateve të nxënësve për jetën dhe punën sipas Kurrikulës së Kosovës. Qendra do të ketë hapësira të pajisura me teknologji për arsim, mjete dhe materiale që do t’u mundëson nxënësve të marrin pjesë në projekte praktike, me qëllim të zhvillimit të shkathtësive dhe kompetencave relevante tek nxënësit. Qendra do të jetë në dispozicion të mësimit dhe nxënësve gjatë orarit mësimor dhe po ashtu do të jetë në dispozicion për aktivitete jashtë-kurrikulare në mbrëmje dhe në fundjavë, siç është e paraparë në Kurrikulën e Kosovës.



Trajnimin dhe mentorimin e ekipit të shkollës në zbatimin e edukimit për karrierë, mësimin për ndërmarrësi dhe atë të bazuar në projekte, siç është paraparë në Kurrikulën e Kosovës.

Trajnimin dhe mentorimin e ekipit të shkollës në vlerësimin e rezultateve të të nxënësve të kurrikulës për jetën dhe punën.

Themelimin e lidhjeve në mes të shkollës dhe punëdhënësve, që do të rrisë shkathtësitë e nxënësve për punësim.

Ofrimin e trajnimeve, materialeve dhe udhëzuesve për mësimdhënësit dhe nxënësit e përzgjedhur për themelimin e Klubit Teknik të nxënësve, i cili do të ndihmon në mirëmbajtjen dhe sigurinë e sistemeve kompjuterike dhe teknologjisë për arsim në shkollë;

- Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës në muajin nëntor të vitit 2017, ka nënshkruar Marrëveshje bashkëpunimi me IPKO Foundation, qëllimi i të cilit është të mbështesë inovuesit e rinj dhe zhvillimin e brezit të ardhshëm të liderëve me vizion digjital për Kosovën. IPKO Foundation investon drejtpërdrejtë në zhvillimin profesional të të rinjve dhe fëmijëve të Kosovës, duke nxitur edukimin e të rinjve, promovimin e edukimit jo formal dhe theksimin në rritjen e aktiviteteve që synojnë edukimin jo formal, zhvillimin e gjeneratave të reja liderë në teknologji dhe inovacion, ka nevojë për mbështetje institucionale, në mënyrë që qasja të këta të rinj të realizohet në mënyrë të mirëfilltë dhe të rregulltën në të gjitha komunat e Kosovës duke përfshirë këtu edhe Komunën e Prishtinës. Kjo marrëveshje formon kornizën për bashkëpunimin midis palëve për të identifikuar dhe arritur qëllimet dhe objektivat e përbashkëta dhe për të lehtësuar dhe zhvilluar një proces shkëmbimi të sinqertë dhe reciprokisht të dobishëm. Ky Memorandum nuk është detyrues dhe nuk imponon asnjë detyrim ligjor apo financiar të asnjëra palë. Bazuar në këtë marrëveshje, Komuna e Prishtinës do të përkrahë IF-në organizimin e prezantimeve dhe aktiviteteve në shkollat e mesme të komunës, përfshirë edhe paralelet e ndara nëpër fshatra, si dhe përzgjedhjen e nxënësve për përfshirje në aktivitete praktike jashtëmësimore.
- Drejtoria e Arsimit në bashkëpunim me Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), me ndihmën e OBSH-së dhe OJQ-së PEN, kanë realizuar fazën e parë të projektit “Për nxënës të shëndetshëm”.

Ky projekt u dedikohet nxënësve të shkollave të Prishtinës, ku për çdo javë në secilën shkollë do të shkojnë staf profesional mjekësor, që do të kenë si qëllim në vete edhe edukimin e fëmijëve për shëndetin, e jo vetëm kontrollin apo intervenimin. Kjo nismë bëhet me qëllim të vetëdijesimit të nxënësit qysh në moshën e hershme për përgjegjësitë që kanë në raport me shëndetin, në mënyrë që t'i parandalojnë problemet eventuale shëndetësore në të ardhmen.





Secila Qendër e Mjekësisë Familjare do të formojë ekipe me nga dy persona, ku përfshihet një mjek familjar apo stomatolog dhe një infermiere apo asistente e stomatologjisë. Temat që do t'iu ligjërohen nxënësve nga ky staf profesional, do të përzgjidhen varësisht moshës që kanë nxënësit.

Fillimisht, projekti po testohet në 3 shkolla, meqë së shpejti do të nis vizitat sistematike. Tutje, do të

vazhdohet në secilën shkollë të Prishtinës, me të gjithë nxënësit nga klasa e parë (I) deri në klasën e nëntë (IX);

- Përgatitja e raportit për suksesin dhe rezultatet e nxënësve, të arritura në tri nivelet e arsimit parauniversitar gjatë gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2016/17;
- Përgatitja e raportit për suksesin dhe rezultatet e nxënësve, të arritura në tri nivelet e arsimit parauniversitar, në shkollat publike dhe private, për vitit shkollor 2016/17;
- Grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave, mbi rezultatet dhe suksesin e arritur në secilën lëndë gjatë vitit shkollor 2016/17, në të tri nivelet e arsimit parauniversitar;
- Drejtoria e Arsimit, në funksion të ngritjes dhe përmirësimit të cilësisë në arsim, ka realizuar një analizë dhe vlerësim të detajuar mbi planifikimin dhe realizimin e punëve dhe detyrave të përcaktuara nga institucionet edukativo-arsimore të nivelit të arsimit parauniversitar, për periudhën kohore shtator-dhjetor 2017. Po ashtu, janë analizuar dhe studiuar të dhënat e ofruar nga shkollat, se a janë realizuar objektivat e caktuara në mënyrë profesionale nga organet e brendshme të shkollës;
- Trajnimi permanent për zhvillimin profesional të personelit edukativ-arsimor, në bashkëpunim (MASHT, OJQ-të);
- Në koordinim me Drejtorinë e Arsimit të Komunës së Prishtinës, Fushë-Kosovës dhe Obiliqit, u realizua trajnimi i mësimeve për "Paketën e Gjelbër Junior" dhe ndërlidhja e saj me zhvillimin e qëndrueshëm dhe kurrikulën bërthamë. „Paketa e Gjelbër Junior“ është hartuar me qëllim që t'iu sigurojë mësuesve dhe nxënësve një material origjinal, atraktiv dhe me qasje të lehtë për mësim dhe përvetësim të njohurive për temat nga sfera e zhvillimit të qëndrueshëm në klasat e para të shkollave fillore (nga 6 deri 10 vjeç). Paketa multimediale përbëhet prej dy llojeve të materialeve edukative: doracak për arsimtarë, DVD interaktive, përfshirë dhe lojëra.



Të gjitha janë të lidhura mes vete dhe janë dedikuar për shfrytëzim paralel gjatë orëve të mësimit dhe aktiviteteve të jashtme. Përgatitja e DVD-së “Paketa e Gjelbër Junior” për Kosovë u mundësua përmes bashkëpunimit dhe vullnetit të mirë të shumë individëve dhe organizatave, të cilat dhanë kontributin e vet për përmbajtjen e saj.

Qendra Rajonale e Mjedisit e hartoi „Paketën e Gjelbër“ për herë të parë në vitin 2002 për nevojat e shkollave fillore. Që atëherë, REC-u me sukses e përhapit tregimin për „Paketën e Gjelbër“ nëpër gjithë Evropën Qendrore dhe Lindore. Duke iu falënderuar përpjekjeve të përbashkëta të REC-ut, partnerëve tanë të përkushtuar dhe bashkëpunëtorëve, është mundësuar që materialet edukative dhe mjetet mësimore nga „Paketa e Gjelbër“, të adaptohen për shfrytëzim në 20 gjuhë në 18 shtete. Arsimimin për mjedisin tani e afroam deri tek 4,5 milionë nxënës dhe 40.000 arsimtarë.

Ky material i ri arsimor hapi një kapitull të ri në përpjekjet tona që të zgjerohet grupi qëllimor dhe t’u prezantohet „Paketa e Gjelbër“ fëmijëve përmes zhvillimit të një “Pakete të Gjelbër Junior”. Versioni „Paketa e Gjelbër Junior“ i Kosovës, i vetmi deri tani, përmban mjete plotësuese



edukative, të zhvilluara si rezultat i bashkëpunimit të përbashkët në mes të ekipit të REC-ut dhe grupeve të mësimdhënësve dhe ekspertëve kompetentë nga shkollat fillore dhe institucionet tjera në Kosovë.

Ky prodhim është edhe një tjetër tregim i suksesshëm i lidhur me përpjekjet e REC-ut për ngritjen e kapaciteteve të mësimdhënësve dhe trajnuesve aktualë dhe të ardhshëm për mbështetje në zhvillimin e institucioneve dhe programeve që e rrisin cilësinë e arsimit për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm në Evropën Qendrore dhe Lindore.

“Paketa e Gjelbër Junior” ndihmon në zhvillimin e vlerave të reja te nxënësit dhe një model të ri të sjelljes në shkollë, shtëpi dhe në përgjithësi në shoqëri. Me këtë, fëmijët do të bëhen ambasadorë të qëndrueshmërisë së një shoqërie dhe do t’ua transmetojnë njohuritë dhe shprehitë e tyre të reja miqve dhe rrethit familjar;

- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, pas rishikimit të Kornizës Kurrikulare të arsimit parauniversitar në vitin 2016, ka marrë vendim që nga viti i ri shkollor 2017/18, ky dokument zyrtar të fillojë të zbatohet në tërë shkollat e Republikës së Kosovës, konkretisht në nivelin parafilior, fillor klasa e parë (I), klasa e gjashtë (VI) dhe klasa e dhjetë (X) në gjimnaze.



Është indikativ fakti se Korniza Kurrikulare, tani përcakton një koncept të ri filozofik, e cila do të mundësojë kalimin nga Kurrikula e bazuar në përmbajtje lëndore në një Kurrikulë që promovon dhe mbështetë zhvillimin e kompetencave. Kjo Kurrikulë ndihmon nxënësit, të rinjtë dhe të rejtat, të eksplorojnë dhe kuptojnë botën rreth tyre, të ndërlikojnë përvojat e tyre të të nxënit me jetën e vërtetë dhe zhvillojnë kompetenca në nivel të lartë dhe në përputhje me nevojat dhe interesat e tyre.



Këto zhvillime reformuese në sferën e arsimit, kanë për qëllim edhe harmonizimin e sistemit të arsimit të Kosovës, me sistemin e arsimit të shteteve të zhvilluara evropiane.

Për t'iu përgjigje kësaj situatë në mënyrë profesionale, Drejtoria e Arsimit, në koordinim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, kanë hartuar politika për mbështetjen dhe zhvillimin profesional të mësimitdhënësve për zbatimin e Kurrikulës së re nga viti i ri shkollor.



Drejtoria e Arsimit, nga data 11 deri me 15 prill, në funksion të zhvillimit në këtë segment, ka organizuar trajnim për 457 mësimitdhënësit në shtatë fushat e Kurrikulës, në mënyrë që zbatueshmëria e kurrikulës në shkollat tona nga shtatori i vitit 2017, të jetë në nivelin e kënaqshëm.

Janë gjithsej 17 grupe që kanë zhvilluar trajnimin, të ndarë sipas fushave:

Dy grupe në fushën Gjuhët dhe Komunikimi;
 Dy grupe në fushën e Matematikës;
 Tri grupe në fushën e Shkencave Natyrore;
 Tri grupe në fushën Shoqëria dhe Mjedisi;
 Dy grupe në fushën e Edukatës Fizike;
 Një grup në fushën e Arteve;
 Një grup në fushën e TIK-ut dhe
 Tri grupe në nivelin: parafillor – fillor.

- **Faza e dytë e trajnimit të organizuar për zbatimin e KKK-së**

Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës në koordinim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në funksion të mbështetjes dhe zhvillimit profesional të mësimitdhënësve për zbatimin e Kurrikulës së re nga viti i ri shkollor 2017/18, kanë ndërmarrë hapa konkret në këtë segment, duke organizuar trajnime profesionale.



Drejtoria e Arsimit, në mënyrë që ky proces i filluar të gjejë zbatim në institucionet edukativo-arsimore të nivelit të arsimit parauniversitar, ka ndërmarrë veprime konkrete, duke iu përgjigjur profesionalisht kësaj situatë. Më 29 - 30 prill dhe 6, 7 e 13 maj është organizuar faza e dytë e trajnimit për 400 mësimitdhënës në shtatë fushat e Kurrikulës, në mënyrë që zbatueshmëria e kurrikulës në shkollat tona nga shtatori i vitit 2017, të jetë në nivelin e kënaqshëm.

Gjithsej në këtë fazë janë trajnuar 400 mësimitdhënës, të ndarë 13 grupe, sipas fushave kurrikulare:

Nr.	Fusha e kurrikulës	Numri i grupeve	Numri i mësimitdhënësve
1	Gjuhët dhe komunikimi	4	110
2	Artet	1	29
3	Matematika	1	36
4	Shkencat natyrore	1	28
5	Shoqëria dhe mjedisi	1	44
6	Jeta dhe puna (TIK)	1	28
7	Fillor	3	94
8	Parafillor	1	31

Ku në këtë fazë të trajnimit në komunën e Prishtinës, ishin të përfshirë edhe një numër i konsiderueshëm i mësimitdhënësve të komunës së Obiliqit dhe të Artanës.

Drejtoria e Arsimit, me përkushtim dhe seriozitet të madh iu ka përgjigjur kësaj situatë, duke ditur rëndësinë e madhe që ka implementimi i Kurrikulës së re. Për këtë ka mobilizuar gjithë stafin e saj, në mënyrë që ecuria e trajnimit për zhvillimin profesional të mësimit, të cilët nga vitet e reja shkollor 2017/18 do të fillojnë me zbatimin e Kurrikulës së re, të jenë të përgatitur për ta zbatuar. Në kohë optimale janë njoftuar të gjithë drejtuesit e institucioneve arsimore dhe



mësimit për fazën e dytë të trajnimit. Në kohën e duhur janë bërë përgatitjet teknike nga Drejtoria e Arsimit, ku u zhvillua trajnimi i mësimit dhe është realizuar furnizimi me materiale të nevojshme didaktike për trajnim, në mënyrë që ecuria e trajnimit të rrjedhë sipas dinamikës dhe planifikimit të paraparë. Ky proces në vazhdimësi është monitoruar nga përfaqësuesit e Drejtorisë së Arsimit, duke i mbështetur dhe përcjellë nga afër ecurinë e procesit të trajnimit.

Nga vlerësimi dhe analiza e përgjithshme mbi ecurinë e trajnimit, nga data 29 prill deri me datë 13 maj, arrijmë në përfundim se shumica e mësimit dhe kanë kuptuar rëndësinë e Kurrikulës dhe kanë qenë të përkushtuar gjatë trajnimit, në mënyrë që të përgatitë dhe të zhvillohen profesionalisht për zbatim të KKK-së, por disa nuk ishin të kënaqur me këto zhvillime që janë duke ndodhur në sistemin e arsimit të Republikës së Kosovës, duke u shprehur skeptik për këto ndryshime. Pra, një numër i konsiderueshëm nuk janë të mirëinformuar me këto zhvillime dhe mbi rëndësinë e Kurrikulës dhe kanë një dozë frike.

Po ashtu, në ditën e fundit të trajnimit, më 13 maj, janë përcjellë formularët e vlerësimit të trajnimit për secilin mësimit, ku pas analizës së bërë konstatohet se shumica e mësimit pjesëmarrës deklarohen se janë të kënaqur me trajnimin e mbajtur dhe kanë arritur të fitojnë njohuri të mira për KKK-së, por kërkesë e tyre është që trajnimi të jetë më i gjatë, të organizohen trajnime të ndryshme të cilat do të ndihmonin shumë në implementimin e Kurrikulës, si: trajnimi i MKLSH, vlerësimin formativ dhe sumativ etj., pajisjen me materiale shpeshë dhe organizime më të shpeshta në mes të mësimit.

Po ashtu, kemi realizuar një analizë mbi fletëvlerësimet, ku në vijim do i paraqesim se sa janë të informuar mësimit me reformat që po ndodhin në sistemin e arsimit të Republikës së Kosovës, konkretisht Kurrikulën e re, çfarë mendojnë për reformat, a janë të nevojshme sipas tyre etj.

- Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës, në koordinim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në funksion të mbështetjes dhe zhvillimit profesional të mësimitdhënësve për zbatimin e Kurrikulës së re nga viti i ri shkollor 2017/18, kanë ndërmarrë hapa konkret në këtë segment, duke organizuar trajnime profesionale. Ky proces i filluar për të gjetur zbatim në institucionet edukativo-arsimore të nivelit të arsimit parauniversitar, Drejtoria e Arsimit ka ndërmarrë veprime konkrete, duke iu përgjigjur profesionalisht kësaj situatë kështu që më 29 - 30 qershor dhe 1, 3 dhe 4 korrik, ka organizuar fazën e tretë, ku pjesëmarrës në trajnime ishin 104 mësimitdhënës në fushën e kurrikulës, programit parafillor-fillor dhe gjuhë dhe komunikime, ndërsa 3 mësimitdhënës të matematikës trajnimin e kanë vijuar në Mitrovicë dhe dy në mësimitdhënës në Podujevë, në fushën shoqëria dhe mjedisi. Gjithsej në këtë fazë janë trajnuar 104 mësimitdhënës, të ndarë sipas fushave kurrikulare:

Nr.	Fusha e kurrikulës	Numri i grupeve	Numri i mësimitdhënësve
1	Gjuhë dhe komunikime	1	20
2	Matematikë	Mitrovicë	3
3	Shoqëria dhe mjedisi	Podujevë	2
4	Parafillor-fillor	2	79

Në këtë fazë të trajnimit në komunën e Prishtinës ishin të përfshirë edhe një numër i mësimitdhënësve të komunave të Fushë-Kosovës, Drenasit dhe të Podujevës.

Drejtoria e Arsimit, me përkushtim dhe seriozitet të madh iu ka përgjigjur kësaj situatë, duke ditur rëndësinë e madhe që ka implementimi i Kurrikulës së re. Për këtë ka mobilizuar gjithë stafin e saj, në mënyrë që ecuria e trajnimit për zhvillimin profesional të mësimitdhënësve, të cilët nga vitit shkollor 2017/18 do të fillojnë me zbatimin e Kurrikulës së re, të jenë të përgatitur për zbatim.



Në kohë optimale janë njoftuar të gjitha drejtuesit e institucioneve arsimore dhe mësimitdhënësit për fazën e tretë të trajnimit dhe vendin ku do zhvillohet. Nga Drejtoria e Arsimit në kohë të duhur janë bërë përgatitjet teknike, ku u zhvillua trajnimi i mësimitdhënësve dhe është realizuar furnizimi me materiale të nevojshme didaktike për trajnim.

Trajnimi është mbajtur më 29, 30 qershor dhe 1 korrik në shkollën fillore “Dardania”, ndërsa më 3 - 4 korrik trajnimi është mbajtur në shkollën fillore “Xhemail Mustafa”.

Në mënyrë që ecuria e trajnimit të rrjedhë sipas dinamikës dhe planifikimit të paraparë, në vazhdimësi ky proces është monitoruar nga përfaqësuesit e Drejtorisë së Arsimit, duke i mbështetur dhe përcjellë nga afër ecurinë e procesit të trajnimit.

Nga vlerësimi dhe analiza e përgjithshme mbi ecurinë e trajnimit, nga data 29 qershor



deri më 4 korrik, arrijmë në përfundim se shumica e mësimeve të mësimdhënësve e kanë kuptuar rëndësinë e Kurikulës dhe kanë qenë të përkushtuar gjatë trajnimit, në mënyrë që të përgatiten dhe të zhvillohen profesionalisht për zbatueshmëri të KKK-së, por disa nuk ishin të kënaqur me këto zhvillime që janë duke ndodhur në sistemin e arsimit të Republikës së Kosovës, duke qenë skeptik me këto ndryshime. Pra një numër i konsiderueshëm nuk janë të mirëinformuar me këto zhvillime dhe mbi rëndësinë e Kurikulës dhe kanë një dozë frike;

- **Drejtorja e Arsimit e Komunës së Prishtinës**, në bashkërendimi me Qendrën për Arsim të Kosovës dhe Inspektoratin e Arsimit, gjatë muajit mars të vitit 2017, në funksion të ngritje dhe zhvillimit profesional të akterëve mbikëqyrës në procesin edukativo-arsimor, kanë organizuar trajnimin “Vlerësimi i kompetencave të edukatorëve” për inspektorët e arsimit dhe zyrtarët komunalë. Pra, qëllimi i trajnimit ishte përveç mbështetjes profesionale të pjesëmarrësve, ishte edhe njohja e tyre edhe me dokumentin zyrtar për kompetencat e edukatoreve, të botuar nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC), në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), si dhe me instrumentin vlerësues dhe data-bazën elektronike;



- Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës, në koordinim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, nga muaji dhjetor i vitit 2017, kanë filluar procesin e vlerësimit të dosjeve të mësimit të cilët e kanë përfunduar trajnimin e KK-së dhe janë duke e zbatuar atë në praktikë, në nivelin parafillor (klasën përgatitore), klasën e parë (I), të gjashtë (VI) dhe të dhjetën (X) në gjimnaze. I gjithë procesi i vlerësimit të dosjeve të mësimit është duke u realizuar në shkollën fillore “Faik Konica”.



Për procesin e vlerësimit të dosjeve të edukatoreve/mësimit, janë caktuar personat kompetentë, të cilët në koordinim me përfaqësuesit e Drejtorisë së Arsimit, janë duke e realizuar këtë proces, ku vlerësimi i dosjeve është përcaktues për certifikimin e mësimit, të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret sipas standardeve të përcaktuara.



Pra, procesi i vlerësimit të dosjeve të mësimit ka për qëllim identifikimin se sa mësimit kanë arritur ta kuptojnë dhe ta zbatojnë në praktikë kurrikulën e re dhe njëkohësisht mbështetjen e tyre me këshilla profesionale, në mënyrë që ky proces i filluar të gjejë zbatim në institucione edukativo-arsimore.

- Në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit të lidhur në mes të Komunës së Prishtinës dhe komunave të tjera me organizatën KEEN për hartimin e planeve lokale të veprimit në fushën e arsimit, projekti "Kosovo Education and Employment Network - KEEN" ka organizuar punëtorinë njëditore për prezantimin e kornizës për zhvillimin e planeve komunale të veprimit, në të cilën pjesëmarrës ishin përfaqësues komunalë nga komuna e Prishtina, e Ferizajit, e Graçanicës, e Gjakovës, e Lipjanit, e Fushë-Kosovës, e Pejës, e Gjilanit, e Mitrovicës dhe e Prizrenit.

KEEN është projekt i financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga një koalicion strategjik i udhëhequr nga Qendra për Arsim e Kosovës - KEC dhe organizatat tjera të shoqërisë civile (ATTA, BSFK, APPK, SPARK), të cilat angazhohen në fushën e arsimit, punësimit dhe politikave sociale;



- Në kuadër të memorandumit të bashkëpunimit në mes Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Prishtinës dhe Fakultetit të Edukimit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", më 14 prill 2017, nën patronatin e Fakultetit të Edukimit u organizua një takim i përbashkët me drejtuesit e institucioneve edukativo-arsimore të komunës së Prishtinës.



Ky takim u realizua në shenjë mirënjohjeje për mbështetjen e vazhdueshme profesionale që janë duke e dhënë shkollat e komunës së Prishtinës për studentët të cilët kanë përfunduar praktikën pedagogjike. Me këtë rast, Fakulteti i Edukimit ndau mirënjohje për të gjithë drejtorët e institucioneve të Arsimit Parauniversitar në komunën e Prishtinës.

Në këtë takim morën pjesë drejtoresha e Arsimit të Komunës së Prishtinës, znj.



Arbërie Nagavci, ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, z. Arsim Bajrami, si dhe rektori i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" z. Marjan Demaj.

Znj. Nagavci, në fjalën e rastit i falënderoi të gjithë drejtorët dhe mësuesit për kontributin e tyre të vazhdueshëm për mbështetjen në zhvillimin profesional të studentëve dhe, njëkohësisht potencoi se Komuna e Prishtinës është e fokusuar t'i mbështesë

vazhdimisht kuadrot e reja, në mënyrë që të krijojmë mësues cilësorë dhe profesionalë, sepse kjo do të ndikonte drejtpërdrejt në ngritjen dhe përmirësimin e cilësisë në Arsim;

- Drejtoria e Arsimit në koordinim me Institutin Pedagogjik, kanë realizuar trajnim për përgatitjen e koordinatorëve të cilësisë;

Organizimi i Panairit të Edukimit

Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit në mes të Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Prishtinës dhe Kompanisë Congress & Event Organization (CEO), më 20 dhe 21 prill 2017, në Pallatin e Rinisë (Salla e Kuqe) u organizuar Panairi i Edukimit.

Në Panairin e Edukimit institucionet edukativo-arsimore të nivelit të arsimit të mesëm të lartë, konkretisht shkollat profesionale, prezantuan dhe ekspozuan aktivitetet dhe punët që realizojnë në shkollat e tyre dhe mundësitë që ofrojnë këto institucione.

Pra, qëllimi kryesor i këtij panairi është që nxënësit e klasave të nënta (IX), t'i takojnë përfaqësuesit e shkollave profesionale dhe të njoftohen për së afërmi me kriteret dhe drejtimet e këtyre shkollave, në mënyrë që në të ardhmen të jenë më të përgatitur dhe ta kenë më të lehtë përcaktimin se në cilën shkollë të vazhdojnë studimet. Institucionet arsimore si ekspozues të këtij panairi, patën mundësi të shkëlqyeshme të promovojnë dhe prezantojnë programet e studimit para një numri të konsiderueshëm të nxënësve semimaturantë.

Në mesin e disa aktiviteteve për të rinj, këtë vit si aktivitet kryesor gjatë Panairit të Edukimit, për herë të parë është organizuar edhe konferenca me temën "Mundësitë e studimit brenda dhe jashtë vendit", ku një numër i konsiderueshëm i maturantëve, të cilët vizituan panairin, u informuan për programet e studimit si dhe mundësitë për të siguruar bursa brenda dhe jashtë vendit.

- **Java me dyer të hapura**

Drejtorie e Arsimit e Komunes së Prishtinës, në bashkërendim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në funksion të orientimit në karrierë dhe informimit të nxënësve të klasave të nënta (IX), me drejtimet (profilet) e shkollave të mesme, kanë organizuar aktivitetin “Java e Dyerve të Hapura”.

Një aktivitet me karakter të tillë është paraparë dhe planifikuar edhe në Strategjinë e Edukimit dhe Orientimit në Karrierë 2015-2019.

Pra projekti për orientimin në karrierë, i referohet një sërë aktiviteteve, të cilat janë përcaktuar për të mbështetur dhe ndihmuar nxënësit e klasave të nënta (IX), në zgjedhjen e drejtimeve-profesionin e tyre në arsimin e mesëm të lartë (shkolla profesionale dhe gjimnaze).

Në funksion të këtij projekti, të gjitha shkollat e mesme të larta për një javë rresht, hapën dyert e shkollave, duke pritur nxënësit e shkollave fillore, gjegjësisht nxënësit e klasave të nënta (IX), mësimdhënësit dhe prindërit, ku iu prezantuan profilet, sukseset dhe rezultate e shkollave të tyre.

Ky aktivitet është realizuar me qëllim që nxënësit e këtij nivelit të arsimit të marrin sa më shumë informata për shkollat e mesme të larta (gjimnaze dhe profesionale) dhe drejtimet dhe mundësitë që ofrojnë këto.

Për një informim sa më të detajuar për shkollat e mesme të larta, nxënësit vizitorë i kanë njoftuar përmes informatave, si: fletëpalosje, pankarta, prezantime me video-projektor mbi sukseset dhe rezultatet e shkollës, stafin akademik, kushtet brenda shkollës ku nxënësit zhvillojnë praktikën profesionale, profilet që ofrojnë këto shkolla dhe mundësitë e kycjes në tregun e punës pas përfundimit të shkollës së mesme profesionale. E gjithë kjo ka reflektuar pozitivisht, sepse nxënësit janë të mirë informuar për mundësitë që ofrojnë këto shkolla në zhvillimin e tyre profesional dhe mundësitë për punësim pas përfundimit të shkollës së mesme profesionale.

- Në përpjekje për parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes së shkollës nga nxënësit dhe mosregjistrimit në Arsimin e obliguar, të gjitha institucionet e nivelit fillor dhe të mesëm të ulët të komunës së Prishtinës, kanë themeluar ekipet e shkollave për këtë çështje, duke vepruar në harmoni me Udhëzimin administrativ 19/2012, “Themelimi dhe fuqizimi i ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar”.

Ekipi i shkollave për parandalimin e braktisjes së shkollës, do të ketë pesë anëtarë të rregullt, një udhëheqës në trajtimin e rasteve, një përfaqësues i nxënësve, një përfaqësues të prindërve, një përfaqësues i mësimdhënësve dhe drejtori i shkollës;

- Në vazhden e punëve dhe detyrave të shumta, në mënyrë permanente që është duke i realizuar Drejtoria e Arsimit, në funksion të ngritjes dhe përmirësimit të cilësisë në



arsim, krijimit të kushteve sipas standardeve bashkëkohore për mësimdhënie dhe mësimnxënie cilësore, gjatë muajit mars ka pajisur me literaturë të re bibliotekën e shkollës fillore "Afrim Gashi". Ky furnizim me libra të ri është bërë për t'i plotësuar



kërkesat dhe nevojat të mësimdhënësve dhe nxënësve, gjë e cila do të reflektojë në zhvillimin e tyre profesional.

Drejtorja e Arsimit për t'i plotësuar kërkesat dhe nevojat e shkollave të tjera me literaturë të re bashkëkohore, ka hapur tenderin për pajisjen e 5 shkollave të tjera me 100 tituj të ri;

- Në mbështetje të realizimit të projektit "Kosovision Contest", Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka mbështetur financiarisht nëntë projekte të shkollave fillore dhe Drejtorja e Arsimit e Komunës së Prishtinës ka financuar pesë (5) projekte me vlerë 2500 euro.

Projekte të realizuar nga nxënësit e klasave të pesta, ku përmes tyre kanë shfaqur vizioni e tyre për të ardhmen e vendit në katër fusha të interesit: arsim, infrastrukturë dhe mjedis, bashkëjetesë dhe ekonomi;



- Drejtoria e Arsimit, në kuadër të përmirësimit të cilësisë në arsimit dhe krijimit të kushteve më të mira në institucionet edukativo-arsimore të nivelit të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2016/17, ka pajisur shkollat edhe me 33 kënde të leximit. Tani çdo shkollë ka këndin e leximit, të furnizuar sipas kërkesave dhe standardeve me libra për nxënësit.



Po ashtu, është duke u punuar në vazhdimësi që bibliotekat shkollore të pasurohen me libra të rinj shkollorë.



- Me rastin e shënimit të 11 Tetorit, Ditës Ndërkombëtare të Vajzave, në institucionet edukativo-arsimore të Komunës së Prishtinës u organizuan një varg aktivitesh me karakter edukativo-arsimor. Gjatë kësaj dite patëm nder të vizitojmë "Shkollën e Gjelbër", ku nxënës të shtatë komunave të Republikës së Kosovës:

1. SHFMU "Yll Morina" Gjakovë;
2. SHFMU "Abdyl Frashëri" Prizren;
3. SHFMU "Thimi Mitko" Gjilan;
4. SHFMU "Afrim Abazi" Ferizaj;
5. SHFMU "Lidhja e Prizrenit" Pejë;



- 6. SHFMU "Zenel Hajdini" Podujevë;
- 7. SHFMU "Shkolla e Gjelbër" Prishtinë;

në koordinim me organizata joqeveritare, realizuan projekte të ndryshme inovative në fushën e teknologjisë, duke treguar shkathtësitë dhe kompetencë të lartë.

Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës në koordinim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe organizatën BIT-Austria, realizuan pilotimin e "e-maturës" me nxënësit e gjimnazit "Eqrem Çabej", në "Shkollën e Gjelbër".



- Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës pas analizës dhe vlerësimit të përgjithshëm mbi rrjetin ekzistues të internetit në institucionet arsimore, ka ndërmarrë hapa të mëtutjeshëm për zgjerimin dhe avancimin e tij, për të shpërndarë rrjetin në të gjitha hapësirën e objektit shkollor, me kapacitetet e reja sipas standardeve të kohës.

Drejtoria e Arsimit, në funksion të përmirësimit të infrastrukturës digjitale në shkollat e qytetit, ka ndërmarrë hapa konkrete për shtrirjen e rrjetit WIRELESS dhe avancimin e pajisjeve teknologjike për qasje në internet, duke filluar me shkollën fillore "Hilmi Rakovica", për të vazhduar me institucionet tjera, ku përmes këtij projekti mund të realizohen platformat e ndryshme digjitale.



Përmes këtij projekti mund të realizohen këto platforma digjitale: ditari elektronik, mësimi online, mësimi interaktiv, informimi i nxënësve për materiale dhe detyra online nga mësimdhënësit, bashkëpunimi dhe komunikimi efektiv me prindërit , trajnimet e ndryshme online, testimi i nxënësve online etj. Projekti filloi me implementim në shkollën "Hilmi Rakovica", me shtrirjen e rrjetit wireless në të gjithë objektin, dhe do të vazhdojë ngjashëm edhe me dhjetë shkolla të tjera nga fillimi i vitit të ri shkollor 2017/2018. Ndërsa nga ky projekt, deri në fund të vitit kalendarik 2017, do të përfitojnë të gjitha institucionet edukativo-arsimore.



Projekti do të lehtësojë punën e mësimdhënëësve në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe njëkohësisht do të reflektojë në realizimin e punëve dhe detyrave sipas standardeve më të larta bashkëkohore.

- Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës me rastin e 1 Qershorit, Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, ka organizuar aktivitetin "Prishtina Lexon", për të katërtin vit me radhë. Ky aktivitet ka zgjatur dy ditë, kanë marrë pjesë nxënësit e të gjitha shkollave të komunës së Prishtinës, të ndarë në disa kënde leximi për të lexuar vepra të ndryshme. Po ashtu, shumë personalitete publike, si gazetarë, aktorë dhe politikanë vullnetarisht iu kanë lexuar tregime fëmijëve në këndet e tyre.



Në vazhden e punëve dhe detyrave të shumta në funksion të ngritjes dhe përmirësimit të cilësisë në arsim dhe krijimit të kushteve më të mira në nivelin e arsimit parauniversitar, Drejtoria e Arsimit për vitin e ri shkollor 2017/18, do t'i rrisë kapacitetet ekzistuese për përfshirjen e fëmijëve në nivelin e arsimit parafillor.

Duke parë rëndësinë që ka edukimi në fëmijërinë e hershme: në zhvillimin njohës, fizik, emocional dhe social të tyre, DKA-ja ka ndërmarrë të gjitha veprimet



konkrete për hapjen e paraleleve parafillore në kuadër të shkollave, në mënyrë që të plotësohen kërkesat dhe nevojat e qytetarëve.

Në vazhden e këtyre zhvillimeve për krijimin e kushteve dhe mundësive më të mira për përfshirjen e fëmijëve në këtë nivel të edukimit, DKA-ja për vitin e ri shkollor 2017/18, ka realizuar të gjitha përgatitjet e duhura për hapjen edhe të tri paraleleve të reja parafillore në zonat rurale: një paralele në shkollën fillore "Filip Shiroka"- Slivovë, një paralele në shkollën fillore "Teuta"- Grashticë dhe një paralele parafillore në shkollën fillore "Nëna Terezë" - Teneshdoll.



Deri tani në nivelin e arsimit parafillor, në komunën e Prishtinës janë përfshirë mbi 80-përqind të fëmijëve, pa përfshirë fëmijët në institucionet private. Po ashtu, është duke u punuar në vazhdimësi dhe komfor standardeve e planeve strategjike të arsimit të Republikës së Kosovës, që brenda një kohe të shkurtër të sigurohen mundësi, që në të gjitha shkollat e Komunës së Prishtinës të krijohen hapësira dhe kushte optimale për përfshirjen e fëmijëve në nivelin parafillor.

- **Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës**, në koordinim me Ministrinë e Arsimit, Shkencë dhe Teknologjisë, gjatë muajit nëntor të vitit 2017, kanë lansuar projektin *“Fushata për Arsim më të mirë në Kosovë”*. Ky projekt është mbajtur në sheshin *“Zahir Pajaziti”*, ku pjesëmarrës ishin përfaqësues të lartë shtetëror, ambasadorë të vendeve të ndryshme dhe nxënësit e shkollave të komunës së Prishtinës, ku qëllimi i fushatës ishte që të nxisë aktivizimin dhe mobilizimin e të gjitha akterëve për të kontribuar në ngritje të cilësisë në arsim.



“Fushata për Arsim më të Mirë në

Kosovë” është një fushatë e gjerë në nivel të vendit, për përmirësimin e cilësisë së arsimit në Kosovë, dhe udhëhiqet nga MASHT, me mbështetjen e Bashkëpunimit Gjerman, donatorëve të tjerë dhe organizatave të shoqërisë civile.

- Drejtoria e Arsimit, për të mbështetur Ministrinë e Forcës së Sigurisë të Kosovës në organizimin dhe realizimin e Kampingut veror 2017 me nxënësit e klasave XI dhe XII, ka propozuar dhe përzgjedhur shkollat: *“Eqrem Çabej”*, *Gjin Gazulli”* dhe *“28 Nëntorin”*, pastaj shkollat në fjalë kanë përzgjedhur nga dy nxënë, të cilët morën nga data 05 deri 09 qershor 2017, aktivitet ky që do të zhvillohet në kazermën *“Adem Jashari”* në Ferizaj;
- Aktivitet profesional (seksionet), në funksion të zhvillimit dhe përmirësimit të cilësisë në arsim, gjatë kësaj kohe kanë realizuar punët dhe detyrat e përcaktuara dhe në fund të muajit kanë përgatitë raporte mbi ecuritë dhe zhvillimet e përgjithshëm në shkollë;
- Gjatë kësaj periudhe janë realizuar takime me përfaqësues të këshillave drejtues të institucioneve edukativo-arsimore, ku janë trajtuar çështje të ndryshme në interes të shkollës;
- Drejtoria e Arsimit, sipas kërkesave të shkollave, ka ndihmuar shkollat në themelimin e Këshillave drejtues, duke i përcjellë edhe përfaqësuesit e Komunës sipas UA;
- Për regjistrimin e nxënësve në klasë të dhjetë janë realizuar diskutime, ku janë analizuar dhe vlerësuar trendet e përgjithshme të regjistrimit të nxënësve dhe njëkohësisht në muajin vijues do dalin planifikimet e detajuara për regjistrim e tyre në shkollat e mesme të larta për vitin shkollor 2017/18;
- Mësimi jo formal në të tri nivelet e arsimit parauniversitar, është duke u realizuar sipas planifikimit dhe dinamikës së paraparë;
- Realizimi i praktikës profesionale me nxënësit e shkollave profesionale, është realizuar në një masë, por jo në nivel të kënaqshëm, kjo është si pasojë e disa

faktorëve, si: mos gatishmëria e bizneseve për pranim të nxënësve, mungesa e transportit etj. Pra është indikativ fakti se praktika profesionale për nxënësit e shkollave profesionale është determinuese në zhvillimin dhe përgatitjen e tyre profesionale.

- Përgatitja dhe planifikimi për organizimin e trajnimeve për mësimdhënësit e nivelit parafillor, klasën e parë, klasën e gjashtë dhe klasën e dhjetë, të cilët nga shtatori i vitit 2017, do të fillojnë me zbatimin e KKK së re;
- Takime të rregullta me zyrtarë për arsim në DKA, për të trajtuar çështje me interes e që ndërlidhen me ato të sigurisë në shkolla;
- Vizita në shkolla sipas kërkesave të shkollave, prindërve apo nxënësve;
- Takim me palët e interesit dhe zyrtarë komunalë nga drejtoritë tjera përkatëse;
- Me rastin e 28 Janarit, Ditës Ndërkombëtare të Privatësisë, Drejtorinë e Arsimit të Komunës së Prishtinës, në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe zyrën Komunale për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, organizuan disa aktivitete në institucionet edukativo-arsimore, mbi rolin dhe rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave dhe të privatësisë;
- Shqyrtimi dhe kthimi i përgjigjeve të të gjitha shkresave zyrtare të paraqitura gjatë vitit 2017;
- Për vlerësimin e nxënësve-fëmijëve me nevoja të veçanta, ekipi profesional ka operuar sipas planifikimeve të parapara për adresimin e fëmijëve me nevoja të veçanta. Në këtë periudhë kohore janë vlerësuar nga ekipi vlerësues njëzetënjë (21) nxënës dhe të cilët kryesisht vuajnë nga dëmtimet intelektuale dhe fizike, ku komisioni ka rekomanduar katër (4) nga nxënësit të vijojnë mësimin në Qendrën burimore “Përparimi” dhe të tjerët në shkollat e rregullta;
- Suksesi i përgjithshëm i nxënësve për tri nivelet e arsimit parauniversitar për gjysmëvjetorin e parë 2016/2017;
- Suksesi lëndor për të tri nivelet e arsimit parauniversitar në fund të gjysmëvjetorit të parë 2016/2017;
- Raportimi në SMIA nga institucionet edukativo-arsimore të nivelit parauniversitar, për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë;
- Raporti tremujor për përmbushjen e veprimeve që dalin nga agjenda evropiane 2017;
- Shpallja e konkursit për bursa për studentët e komunës së Prishtinës;
- Drejtoria e Arsimit ka realizuar konkursin për regjistrim të nxënësve në klasën e dhjetë (X), të gjimnazeve dhe të shkollave profesionale, për vitin shkollor 2017/18;
- Gjatë muajit qershor, Drejtoria e Arsimit ka realizuar konkursin për pranimin e fëmijëve në institucionet parashkollore, për vitin kalendarik 2017/18;
- Të dhënat për numrin e nxënësve në shkollat në gjuhën serbe dhe numri i shkollave sipas niveleve për vitin shkollor 2017/2018;
- Procesimi i të dhënave në MASHT, për pedagogët e nivelit 1-5, divizionit për zhvillim profesional të mësimdhënësve;
- Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave për numrin e nxënësve, mësimdhënësve dhe gjendjen e objekteve shkollore për vitin shkollor 2017/18;
- Mbledhja e të dhënave për nxënësit e lindur në periudhën: 01.01.2002 - 31.12.2002 të zgjedhur si mostër për testin PISA 2018;
- Grumbullimi i të dhënave për nxënësit që vijojnë mësimin joformal për vitin shkollor 2017/2018, për të gjitha institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar;

- Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave për testin e Arritshmërisë;
- Mbledhja e të dhënave në institucionet edukativo-arsimore, të kërkuara nga MASHT-i, lidhur me fondin e përgjithshëm të orëve mësimore sipas klasave, numri i paraleleve, fondi i orëve mësimore të mësimdhënësve;
- Koordinimi dhe angazhimi i administruesve dhe monitoruesve për mbarëvajtjen e Maturës shtetërore 2017;
- Realizimi i “Provimit shtetëror të maturës”, gjatë muajit gusht 2017, në koordinim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- Informimi i administruesve dhe monitoruesve për rregullat dhe procedurat e organizimit të Maturës Shtetërore 2017;
- Raportimi mbi përmbushjen e obligimeve nga Plani i Zbatimin të MSA –së;
- Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës, në bashkëpunim me organizatën joqeveritare “Let’s Do It Kosova”, e organizuan aksionin “Ta pastrojmë Kosovën” i cili aktivitet u zhvillua më 24 maj 2017;
Pjesëmarrës në këtë aksion ishin 50 nxënës të SHFMU “Xhemail Mustafa”, 50 nxënës të SHFMU “Qamil Batalli” dhe 100-150 nxënës të gjimnazit “Ahmet Gashi”, të cilët ishin në përcjelljen e mësimdhënësve të tyre.
Nxënësit në mënyrë të organizuar lëvizën nga sheshi “Zahir Pajaziti”, në lagjen “Arbëria”, ku u krye pastrimi i mbeturinave në afërsi të varrezave të qytetit.
- Përgatitja e qendrave testuese për organizimin dhe zhvillimin e “Testit të arritshmërisë” për nxënësit e klasave IX;
- Gjatë kësaj periudhe kohore janë realizuar të gjitha përgatitjet e duhura për zhvillimin dhe mbajtjen e Testit të arritshmërisë 2017, duke krijuar qendrave testuese, angazhimin e administruesve për monitorim të këtij procesit, si dhe përgatitjen e listave të nxënësve të cilët iu nënshtruan testit;
- Përgatitja e të dhënave për “Maturën shtetërore 2017” dhe krijimi i qendrave ku do zhvillohet testi;
- Informimi i administruesve dhe monitoruesve për rregullat dhe procedurat e organizimit “Matura shtetërore 2017”;
- Koordinimi dhe angazhimi i administruesve dhe monitoruesve për mbarëvajtjen e organizimit “Matura shtetërore 2017”;
- Janë shpallur përfituesit e bursave për vitin akademik 2016/17;
- Kanë filluar procedurat e prokurimit për tenderin “ Furnizimi i bibliotekave shkollore me libra”;
- Kanë përfunduar procedurat e prokurimit për projektin “ Inventarizimi i aneksit të shkollës fillore “Faik Konica””;
- Është realizuar pajisja e aneksit të shkollës fillore “Faik Konica”, me inventar të nevojshëm;
- Janë përpunuar dhe futur të dhënat në sistemin SMIA, nga gjitha institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar;
- Është furnizuar me inventar çerdhja në lagjen “Tophane”;
- Në kohë të paraparë janë furnizuar të gjitha institucione edukativo-arsimore me lëndë djegëse, dru dhe pelet;
- Janë furnizuar në vazhdimësi të gjitha institucionet me materiale didaktike, higjienike dhe mallra dhe shërbime tjera;

- Furnizimi i institucioneve arsimore të nivelit fillor (I-V) me kiflet dhe qumësht;
- Është realizuar projekti për furnizimin e shkollave me inventar;
- Për të krijuar kushte të mira sipas standardeve bashkëkohore, Drejtoria e Arsimit gjatë kësaj periudhe ka pajisur institucionet parashkollore me inventar të ri.



- Dy çerdhe të reja me bazë në komunitet, në lagjet "Tophane" dhe "Kodër të Trimave", janë gati për të filluar punën në vjeshtë. Me këtë rast, dyfishohet numri i çerdheve në Prishtinë, për më pak se 4 vjet;
- Janë furnizuar me material higjienik institucionet edukativo - arsimore, në bazë të nevojave të tyre;
- Përgatitja e lëndës për procedura të prokurimit për kabinetet e muzikës;
- Përgatitja e lëndës për procedura të prokurimit për dezinfektimin e institucioneve arsimore;
- Përgatitja e lëndës për procedura të prokurimit për inventarizimin e çerdheve;
- Përgatitja e lëndës për procedura të prokurimit për këndet e leximit në shkollë;
- Planifikimi i buxhetit 2017/18 - përpunimi i të dhënave për buxhet BDMS;
- Ndarja e buxhetit sipas programeve dhe nënprogrameve;
- Janë nënallokuar pagat për 64 institucione shkollore;
- Janë nënallokuar mjetet për mallra dhe shërbime për programe dhe nënprograme;
- Janë zotuar **1901** lëndë për mallra dhe shërbime si shërbime komunale;
- Janë shpenzuar dhe certifikuar **1561** lëndë;
- Pjesëmarrja në procedurat e hapjes dhe vlerësimeve të tenderëve për nevojat e institucioneve arsimore. Në procesin e hapjes dhe vlerësimit të tenderëve marrin pjesë gjithnjë nga dy përfaqësues të Drejtorisë së Arsimit;
- Aprovimi i kërkesave të institucioneve shkollore lidhur me shpenzime nën 100 €;
- Mbajtja e evidencës e lëndëve të zotuar me modul blerje, si dhe dorëzimi në prokurim;

3. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues.

- Vizita të vazhdueshme, të përgjithshme, kontrolluese dhe speciale në institucionet edukativo-arsimore;
- Përgatitjet për organizimin e trajnimeve për mësimdhënësit, të cilët nga viti i ri shkollor 2017/18, do fillojnë me zbatimin e Kornizës së re kurrikulare;
- Menaxhimi i kontratës “Furnizimi me inventar i çerdhes në lagjen “Kodra e Trimave”, përfshirë tërë inventarin e brendshëm, specifikat dhe paramasën e inventarit, e cila mbetet ende në vazhdim;
- Furnizimi i shkollave me pelet;
- Përgatitja e lëndës për procedura të prokurimit për tenderin “ Furnizimi me llap-top dhe projektor i institucioneve arsimore”;
- Përgatitja e lëndës për procedura të prokurimit për pajisjen e shkollave me kamera;
- Përcjellja e shpenzimit të buxhetit sipas planifikimit;
- Transporti për nxënës dhe arsimtar;
- Menaxhimi i kontratave për mallra dhe shërbime;
- Kontrollimi i shpenzimeve për të gjitha institucionet shkollore.

Buxheti i shpenzuar dhe planifikuar sipas BDMS- viti 2017			
Kategoria eko.	Alokim	Shpenzim	Mbetje -S=
Paga	17,921,120.91	17,921,120.91	-
Komunali	620,000.00	616,968.27	3,031.73
FB-10 Mallra dhe shërbime	1,423,405.00	1,408,282.89	15,122.11
FB-21 Mallra dhe shërbime	1,200,000.00	1,188,567.71	11,432.29
Subvencione	210,000.00	204,456.16	5,543.84
Donacione	45,541.21	38,053.48	7,487.73
FB-21-Kapitale	3,160,000.00	3,061,051.29	98,948.71
FB-22-Kapitale	379,584.00	370,054.76	9,529.24
Totali:	24,959,651.12	24,808,555.47	151,095.65
	Planifikimi sipas BDMS		
PAGA-Plani BDMS	18,086,803.00	17,921,120.91	165,682.09
Total mbetje:			316,777.74

4. STATISTIKAT

Të listohen të gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika tjera specifike që mund të ketë drejtoria juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës.

4.1.1. Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese Janar - dhjetor 2017.

4.1.2. Takimet me palë:

- Drejtoria e Arsimit gjatë vitit 2017, ka realizuar mbi **1658 takime** me palë;
- Takimet me palë në Drejtorinë e Arsimit janë të planifikuara katër ditë në javë.

4.1.3. Takimet me institucione të tjera

Për periudhën e muajit janar-dhjetor të vitit 2017, janë realizuar takime me:

- zyrtarë të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- përfaqësuesit e organizatës YIHR;
- përfaqësuesit e organizatës ASSET;
- përfaqësuesit e DOTS;
- përfaqësuesit e GIZ;
- përfaqësuesit e arsimit të Tiranës;
- përfaqësuesit e Ambasadës së Francës;
- përfaqësuesit e Bashkimit Evropian;
- përfaqësuesit e organizatës ALLED;
- përfaqësuesit e organizatës zvicerane “Terre des hommes”;
- përfaqësuesit e organizatës italiane “Reggio Terzo Monde”;
- përfaqësuesit e organizatës MUTE Foundation
- me Ministrinë e Financave;
- përfaqësuesit e Ministrisë së Planifikimit Hapësinor;
- përfaqësuesit e Policisë së Kosovës;
- përfaqësuesit e organizatës joqeveritare për mbrojtjen e fëmijëve – KOMF;
- përfaqësuesit e organizatës PEN;
- përfaqësuesit e KUR “Prishtina”;
- përfaqësuesit e ndërmarrjes komunale “Termokos”;
- përfaqësuesit e KEDS;

- përfaqësuesit e PTT;
- përfaqësuesit e UNICEF-it, lidhur me funksionimin dhe shpenzimet në institucionet parashkollore me bazë komunitet;
- organizatën joqeveritare “Toka”;
- përfaqësuesit e organizatës “Bonevetit”;
- përfaqësues finlandezë.

4.1.4. Diskutime publike/Takimet me qytetarë

4.1.5. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare:

- Gjatë periudhës raportuese në Drejtorinë e Arsimit, kërkesë për qasje në dokumentet zyrtare ka paraqitur Njësia për Hetime të Krimeve Ekonomike dhe Korrupsion;
- Gjatë kësaj periudhe kërkesë për qasje në dokumente zyrtare ka paraqitur edhe Policia e Kosovës.

4.1.6. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër:

- Gjatë periudhës raportuese janar-dhjetor 2017, në Drejtorinë e Arsimit janë pranuar gjithsej **1194** lëndë, prej tyre
 - të pranuar **9 lëndë**,
 - të miratuar **467 lëndë**,
 - të refuzuar **420 lëndë**,
 - të pezulluar **174 lëndë**,
 - të anuluar **3 lëndë**,
 - të hedhur poshtë **1 lëndë** dhe
 - **120 lëndë** janë në proces.

4.1.7. Takime të tjera:

- Takime me drejtues të institucioneve edukativo-arsimore;
- Takime me mësimdhënës, të cilët kanë qenë të ngarkuar për organizimin e manifestimit “Festa e Abetares”;
- Takim me koordinatorët e mësimit tërëditor;
- Takim me trajnerët e kurrikulës.

5. SFIDAT

Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda Drejtorisë, Komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.

- Riorganizimi dhe përcaktimi i përgjegjësive, punëve dhe detyrave në Drejtorinë e Arsimit;
- Mungesa e stafit profesional mbikëqyrës të veprimtarisë edukativo-arsimore;
- Mungesa e një mekanizmi për vlerësimin e performancës së stafit edukativo-arsimor;
- Mungesat e mësimdhënësve nga procesi arsimor dhe sigurimi i lehtë i vërtetimeve nga qendrat mjekësore;
- Numri i vogël i nxënësve në disa shkolla të viseve rurale;
- Kompetenca të përziera dhe jo të qarta;
- Kushtet jo optimale të punës për stafin e Drejtorisë së Arsimit, gjë që po reflekton drejtpërsëdrejti në cilësinë dhe realizimin e punëve dhe detyrave;
- Implementimi i Kurrikulës së re;
- Ndërtimi i objekteve shkollore në disa lagje të qytetit;
- Sistemimi i mësimdhënësve, të cilët janë rrezikuar si pasojë e ndryshimeve të planit mësimor (fondin e orëve) në shkollat ku është duke u implementuar KKK;
- Plotësimi i vendeve të lira me staf arsimor në institucionet e nivelet të arsimit parauniversitar.

6. REKOMANDIME

Shënoni rekomandimet rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve, nëse keni, dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtorëve, furnizim me pajisje shtesë etj.

- Riorganizimi i menjëhershëm i Drejtorisë së Arsimit, në bazë të përgjegjësive, punëve dhe detyrave që ka kjo drejtori;
- Plotësimi i stafit profesional, sipas kërkesave dhe nevojave të Drejtorisë së Arsimit;
- Formimi i një organi mbikëqyrës të performancës së veprimtarisë edukativo-arsimore;
- Riorganizimi i rrjetit shkollor të viseve rurale të komunës së Prishtinës;
- Sigurimi i hapësirës dhe kushteve të përshtatshme për punë për stafin e Drejtorisë së Arsimit;
- Përmirësimi i pozitës materiale të stafit profesional të Drejtorisë së Arsimit.

7. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES

Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues:

- Mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor;
- Vizita sistematike në institucionet edukativo-arsimore;
- Vizita speciale IEAA;

- Kontrollim dhe monitorim i rregullt i institucioneve parashkollore, sipas dinamikës së planifikimit;
- Operimi i ekipit profesional në mbështetje të shkollave për ngritjen e cilësisë;
- Fuqizimi i aktiveve profesionale (seksioneve), në funksion të zhvillimit, mbështetjes dhe përmirësimit të cilësisë në arsim;
- Analiza e nevojave për stafin menaxhues dhe hartimi i plan të trajnimit;
- Organizimi i trajnimeve për stafin menaxhues, në përputhje me nevoja dhe planet e trajnimeve;
- Krijimi i skemave për stimulimin e menaxhimit të suksesshëm në institucionet- edukativo-arsimore;
- Zbatimi i stimulimit për sukses në menaxhimin e institucioneve edukativo-arsimore;
- Delegimi i autorizimeve nga niveli qendror në nivelin lokal dhe shkollë;
- Ushtrimi i autorizimeve të bartura në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Bashkëpunimi me këshillat drejtues të institucioneve edukativo-arsimore;
- Përkrahje në themelimin e këshillave drejtues, sipas nevojës;
- Themelimi i institucioneve parashkollore me komunitetin në bazë;
- Organizimi i trajnimeve permanente për zhvillim profesional të personelit edukativ (MASHT, OJQ);
- Realizimi i projektit “Furnizimi i shkollave me rekuizita sportive”;
- Furnizimi sistematik i institucioneve arsimore me naftë;
- Furnizimi sistematik i shkollave me kiflet dhe qumësht;
- Furnizimi i institucioneve parashkollore me mjete didaktike dhe rekuizita;
- Fillimi i realizimit të projektit “Furnizimi me instrumente muzikore i kabineteve të muzikës”;
- Furnizimi i të gjithave institucioneve të nivelit parauniversitar me materiale didaktike;
- Operimi i ekipit vlerësues profesional për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;
- Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në institucione edukativo-arsimore;
- Monitorimi dhe integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe rekomandimet për adresim më efektiv të problemeve;
- Organizimi i mësimi joformal në tri nivelet e arsimit (në bashkëpunim me MASHT dhe Qendrën Rajonale të Aftësisimit Profesional);
- Organizimi i diskutimeve publike me komunitetin e prekur nga riorganizimi i rrjetit të shkollave.

8. TË TJERA

Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme:

- Procesi i rekrutimit të stafit edukativo-arsimor dhe të tjerë, sipas ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës është kompetencë dhe përgjegjësi e Drejtorisë së Arsimit dhe duhet të menaxhohet nga ekipet e saj profesionale e jo nga Zyra e personelit, sepse deri tani ky proces i menaxhuar nga kjo zyrë ka reflektuar keq në procesin arsimor.
- Investimet kapitale në institucionet edukativo-arsimor dhe zyrtarët për infrastrukturë shkollore, të kthehen nën menaxhimin dhe udhëheqjen e Drejtorisë së Arsimit, sepse Drejtoria për Investime Kapitale nuk ka treguar shkathtësi dhe efektivitet të kënaqshëm në përmbushjen e kërkesave të shkollave dhe në realizimin e punëve cilësore;
- Organizimi dhe realizimi i ekskursioneve në Republikën e Shqipërisë nga nxënësit e nivelit të arsimit të mesëm të lartë (maturantët), të ndërpriten si të tilla, ose të organizohen në nivelin e duhur, në mënyrë që të ketë karakter njohës, edukativ dhe arsimor.